

# Raport Monitorimi

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA  
NË NIVELIN E QEVERISJES VENDORE

NJE VLERËSIM KRAHASUES  
I PROGRAMEVE TE TRANSPARENÇES  
NË 12 BASHKI TË VENDIT



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim





Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

RAPORT MONITORIMI  
**TRANSPARENCA DHE  
LLOGARIDHËNIA NË NIVELIN  
E QEVERISJES VENDORE**

NJË VLERËSIM KRAHASUES I  
PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS  
NË 12 BASHKI TË VENDIT

TIRANË  
2021

### **Raporti u përgatit nga:**

Megi Reçi, Eksperte në Çështjet e Transparencës dhe Integritetit  
Armela Xhaho, Hulumtuuese, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Ky raport monitorimi u hartua në kuadër të Projektit “Monitorimi Qytetar i Transparencës dhe Llogaridhënies në Nivelin e Qeverisjes Vendore”. Të dhënat për hartimin e këtij raporti u përfatuan nga analizimi i 12 raporteve vendore të transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor të hartuara nga ekspertë të shoqërisë civile nëpërmjet asistencës teknike të IDM-së.

### **Ekspertët e organizatave të shoqërisë civile:**

Diana Kasa, “Tjetër Vizion”, Elbasan  
Diana Andoni, “Gruaja në Zhvillim, Korçë”, Korçë  
Gent Imeraj, “Aleanca Alpeve Shqiptare”, Shkodër  
Gentiana Deçolli, “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore”, Berat  
Engjëllush Serjani, “Qendra Kulturore Mediatike ANTIGONEA”, Gjirokastrë  
Kristjan Marku, “Power of Education”, Lezhë  
Mirjam Reçi, “Civil Society Development Centre”, Durrës  
Nevila Jaha, “Epoka e Re”, Fier  
Romina Sefa, “Qendra për Advokim Social”, Tiranë  
Simo Ribaj, “Green Vision”, Vlorë  
Verdi Shehu, “Agrita Vision”, Dibër  
Vera Istrefi, “Qendra e Gruas”, Kukës

### **Kontribuuan në hartimin e raporteve vendore:**

Lorena Totoni, Eksperte e Qeverisjes Vendore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim  
Dior Angjeli, Asistent Projekti, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

*Ky grant u bë i mundur nga “Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën”, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbytja dhe rekomandimet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe as të Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).*



Norwegian Embassy



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

<b>1. Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>2. Kuadri ligjor dhe institucional për të drejtën e informimit në nivel vendor</b>	<b>8</b>
2.1 Kuadri ligjor për të drejtën e informimit	8
2.2 Kuadri institucional për të drejtën e informimit dhe roli i OSHC-ve vendore	12
<b>3. Aksesimi në informacion: Jetik për demokracinë vendore dhe fuqizimin e qytetarëve</b>	<b>14</b>
3.1. Monitorimi i të drejtës së informimit nga aktorët jopublikë	15
<b>4. Metodologjia</b>	<b>20</b>
<b>5. Raportimi i gjetjeve</b>	<b>23</b>
Fusha I - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë	24
Fusha II - Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare	30
Fusha III - Kërkesat për informim	35
Fusha IV - Shërbimet që ofron bashkia	38
Fusha V - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore	41
Fusha VI - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje	43
Fusha VII - Informacion tjetër	47
<b>6. Përfundime</b>	<b>50</b>
<b>7. Rekomandime</b>	<b>54</b>
<b>8. Shtojcat</b>	<b>58</b>
Shtojca 1. Bashkitë pa Program Transparence	58
Shtojca 2. Tabelë përmbledhëse: Niveli i transparencës së PT-së sipas bashkive	62
Shtojca 3. Fushat, nënfushat dhe treguesit e sistemi të matjes së transparencës dhe llogaridhënies në nivel bashkie	63



# 1. Hyrje

Në praktikat më të mira të qeverisjes vendore, transparencja konsiderohet si baza e qeverisjes së mirë dhe komuniteteve të forta. Transparenca e institucioneve vendore lufton korrupsionin, rrit besimin e qytetarëve si dhe forcon integritetin e lidershit vendor. Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies vendore nga aktorët jopublikë ka një rëndësi të veçantë në nxitjen dhe promovimin e qytetarisë aktive në proceset vendimmarrëse. Për më tepër, ai është një mjet efikas që nxit llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendore. Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje është me rëndësi për forcimin e demokracisë vendore dhe për minimizimin e praktikave korruptive.<sup>1</sup> Ky proces bën të mundur që qytetarët të vlerësojnë objektivisht cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike, duke propozuar ndryshime në lidhje me përmirësimin e shërbimeve të ofruara. Transparenca e institucioneve vendore është parakusht i domosdoshëm për një qeverisje të hapur dhe demokratike. Nga ana tjetër, qeverisja e hapur është më e kontrollueshme nga qytetarët, pasi aksesin në informacionin publik u mundëson atyre të jenë të informuar për punën që bën qeveria. Kur janë të informuar, qytetarët e kanë më të lehtë të monitorojnë sjelljen e zyrtarëve vendorë dhe të kërkojnë transparencë të veprimeve që ndërmerren në interes të publikut. Aksesin në informacionin publik është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe hapi i parë drejt demokracisë vendore me pjesëmarrje. E drejta për t'u informuar në Shqipëri garantohet ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në këtë drejtim, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritete publike, mbartin detyrimin e garantimit të kësaj të drejte për të siguruar transparencë në veprimtarinë e tyre.

Ligji Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" u garanton qytetarëve aksesin te dokumentet zyrtare dhe parashikon që institucionet shtetërore të vënë në dispozicion informacionin pa kërkuar motivet. Dhënia e informacionit pa kërkesë realizohet përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës, të cilin duhet ta publikojë çdo institucion. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar një model të Programit të

....

1 Advocacy Training & Resource Center. (2012) Pjesëmarrja Qytetare në Vendimmarrje në Nivel Lokal. Prishtinë: ATRC

Transparencës (PT) për qeverisjen vendore<sup>2</sup> dhe 61 bashkitë e vendit kanë detyrimin ligjor ta zbatojnë atë dhe të jenë pro-aktive në informimin e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë në lidhje me veprimtarinë e tyre.

Aktorët jopublikë, ku përfshihen organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit, kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës dhe monitorues të zbatimit të Programit të Transparencës. Këta aktorë shërbejnë si instrumente efikase për të ushtruar “presion” ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore për më shumë llogaridhënie duke nxitur në këtë mënyrë konkurrencën mes tyre si dhe për përmirësimin e performancës. Monitorimi i PT nga shoqëria civile synon të nxisë parimin e llogaridhënies horizontale nga aktorët jopublikë.

Gjatë periudhës shtator-tetor 2020, 12 OSHC vendore monitoruan dhe vlerësuan Programin e Transparencës të publikuar në faqet zyrtare të internetit të bashkive. Në vijim, përmes asistencës teknike të IDM-së, OSHC-të hartuan raporte monitorimi të transparencës dhe llogaridhënies, gjetjet e të cilave u prezantuan dhe u vleftësuan në 12 tryeza vendore, ku morën pjesë përfaqësues nga bashkitë, shoqëria civile, media dhe aktorë të tjerë kryesorë vendorë.

Të dhënat për hartimin e këtij raporti u gjeneruan nga analiza krahasimore e 12 raporteve vendore të transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor të hartuara nga ekspertë të shoqërisë civile.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është vlerësimi i transparencës proaktive të 12 bashkive qendër qarku (Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë), përmes monitorimit të Programit të Transparencës. Ky raport synon edhe përmirësimin e zbatimit të së drejtës së informimit, nëpërmjet monitorimit dhe kontributit që mund të japin OSHC-të vendore në zbatimin efektiv të ligjit. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti synojnë të nxisin më tej institucionet e pushtetit vendor për të rritur nivelin e transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit në PT. Procesi i monitorimit u zhvillua gjatë periudhës **shtator-tetor 2020** duke përdorur instrumentin e Sistemit të Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies, i cili është dhe instrumenti bazë për monitorimin e Programit të Transparencës.

Raporti është i strukturuar në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë të raportit jepet një hyrje e përgjithshme duke përshkruar shkurtimisht qëllimet e raportit. Në pjesën e dytë bëhet një përmbledhje dhe analizë e kuadrit ligjor dhe institucional për të

....

2 Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr.211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”.



drejtën e informimit në nivel vendor. Më pas paraqitet një panoramë e përgjithshme e studimeve apo raporteve të publikuara për të drejtën e informimit, monitorimin e transparencës, llogaridhënies dhe përpjekjeve anti-korrupsion për bashkitë përkatëse. Në pjesën e katërt përshkruhet metodologjia si instrumenti bazë për procesin e monitorimit. Në pjesën e pestë të raportit paraqiten gjetjet kryesore nga analiza e monitorimit të shtatë fushave të Programit të Transparencës të 12 bashkive gjatë periudhës gusht-shtator 2020. Në përfundim, ofrohen disa rekomandime për përmirësimin e transparencës në nivel vendor.

## 2. Kuadri ligjor dhe institucional për të drejtën e informimit në nivel vendor

### 2.1 Kuadri ligjor për të drejtën e informimit

#### Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Dokumenti më i rëndësishëm në hierarkinë e akteve normative që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e informimit është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ajo garanton të drejtën e informimit si dhe të drejtën e kujtudo për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore/personave në funksione shtetërore.<sup>3</sup> Ndërsa sanksionimin e parimit për një qeverisje të hapur dhe transparente, e gjejmë në mënyrë të tërthortë si më poshtë: "Kujtudo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive."<sup>4</sup>

#### Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative"

Parimi i transparencës i sanksionuar në Kodin e Procedurave Administrative i detyron organet publike të jenë transparente dhe të bashkëpunojnë ngushtë me persona fizikë dhe juridikë të përfshirë në veprimtarinë e tyre administrative, pra me qytetarët dhe grupet e interesit.<sup>5</sup> Po ashtu në Kodin e Procedurave Administrative sanksionohet parimi i informimit, ku theksohet se: "Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit"<sup>6</sup>. Më tej, Kodi i Procedurave Administrative përshkruan detyrimet e administratës për informimin e qytetarëve, duke mbështetur parimin e një administrate të hapur dhe transparente.<sup>7</sup>

....

- 3 Kushtetuta e Shqipërisë, neni 23
- 4 Po aty.
- 5 Kodi i Procedurave Administrative, neni 5
- 6 Kodi i Procedurave Administrative, neni 6
- 7 Po aty, nenet 51-55

## Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”

Ligji kryesor që garanton të drejtën e informimit në lidhje me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike është Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, miratuar më 18.09.2014. Ky ligj synon garantimin e njohjes së publikut me informacion në kuadër të ushtrimit në praktikë të të drejtave dhe lirive të individit si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë. Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike<sup>8</sup>. Si çdo e drejtë e njeriut, e drejta për informimin u përket të gjithëve. Neni 2 i ligjit ka përcaktuar se kërkues mund të jetë çdo person, fizik apo juridik, vendas apo i huaj, apo edhe pa shtetësi.

Ligji parashikon informimin me kërkesë dhe informimin pa kërkesë. Informimi me kërkesë është e drejta e qytetarëve për të kërkuar informacion pa shpjeguar motivet e kërkesës dhe detyrimi i institucioneve publike për të përmbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizimet e të drejtës së informimit.<sup>9</sup> Informimi pa kërkesë është detyrimi i institucioneve publike për të publikuar në mënyrë proaktive një gamë të gjerë informacionesh publike që prodhohen dhe disponohen prej tyre. Informimi pa kërkesë realizohet nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili përkufizohet si tërësia e informacionit dhe format e bërjes publike të tij nga autoriteti publik. Programi i Transparencës i bën bashkitë proaktive në lidhje me ofrimin e informacionit publik dhe nëpërmjet tij bashkitë synojnë t’u garantojnë qytetarëve të tyre të drejtën e lirisë së shprehjes për çështjet vendore. Në nenin 7 të Ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, janë parashikuar të gjitha kategoritë e informacionit që duhet të përmbajë Programi i Transparencës, ndërsa në nenin 6 është parashikuar që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri) miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike. Komisioneri, me Urdhrin Nr. 211, datë 10.09.2018, ka miratuar programin model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Referuar urdhrit të Komisionerit, duhej që bashkitë të kishin hartuar dhe miratuar programin e ri të transparencës brenda datës 1 janar 2019. Ndonëse Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është renditur në vendin e 6-të në botë për sa i përket parashikimeve të tij, në praktikë zbatimi i tij has ende në vështirësi.<sup>10</sup>

....

8 Ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 1

9 Po aty, neni 3.

10 Shih <https://www.law-democracy.org/live/rti-rating/global/>

## Ligji Nr. 139 /2014 “Për vetëqeverisjen vendore”

Një nga ligjet më të rëndësishme që rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, si dhe përcakton funksionet, kompetencat dhe të drejtat e tyre është ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore”. E drejta për informim e qytetarëve në nivel lokal përcaktohet edhe në këtë ligj duke siguruar transparencën në punën e organeve të qeverisjes vendore dhe mundësinë që publiku të marrë pjesë aktive në qeverisje. Ligji i kushton rëndësi dhe hapësirë të veçantë garantimit të së drejtës së informimit të qytetarëve dhe pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje. E drejta e publikut për informim dhe parimi i transparencës të sanksionuara në këtë ligj përfshijnë detyrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre, të publikojnë aktet e tyre në faqen zyrtare të internetit dhe t’i afishojnë.<sup>11</sup> Po ashtu ligji përcakton që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.<sup>12</sup>

## Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligji përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

## Ligji Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ka në objektin e tij rregullimin e procedurave të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, transfertat nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, përcaktimin e rregullave për politikat, instrumentet dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në nivel vendor, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për financimin e funksioneve të vetëqeverisjes

....

11 Ligji nr.139 /2014 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 15/1 dhe 15/2

12 Po aty, neni 15/3

vendore. Ky ligj e parashikon parimin e transparencës në disa nene të tij<sup>13</sup>, që lidhen me transfertat nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, politikat e menaxhimit të fondeve publike, marrëveshjet që lidhin njësitë e qeverisjes vendore dhe shitjen/dhënien me qira të pronave dhe asetëve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky ligj parashikon, gjithashtu, detyrimin e njësisë të qeverisjes vendore për të publikuar dokumente me rëndësi, të tilla si vendimet për detyrimet fiskale vendore, bazën e taksave dhe tarifave, gjobat dhe kamatëvonesat e aplikueshme, asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose dhënie me qira, dhe buxhetin vjetor. Ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore” është i rëndësishëm edhe për faktin se parashikon dokumentet financiare për të cilat njësi e qeverisjes vendore është e detyruar të kryejë konsultim publik, si p.sh., Programi Buxhetor Afatmesëm<sup>14</sup> dhe taksat e përkohshme vendore<sup>15</sup>.

### Ligji Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”

Ky ligj që ka si qëllim kryesor rregullimin e shërbimit civil dhe marrëdhënies mes shtetit dhe nëpunësve civil, e rendit transparencën si një ndër parimet kryesore të administrimit të shërbimit civil.<sup>16</sup> Gjithashtu, ky ligj parashikon detyrimin e çdo nëpunësi civil (këtu përfshihet edhe administrata vendore) për transparencë dhe informim ndaj publikut: “Nëpunësi civil ka detyrimin të ushtrojë detyrën e tij në shërbimin civil me transparencë dhe të sigurojë për publikun e gjerë dhe palët çdo informacion të nevojshëm, me përjashtim të rasteve, kur ai është klasifikuar sekret shtetëror sipas ligjit.”<sup>17</sup>

....

- 13 Ligji Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2/2, 2/6, 12/3, 19/5
- 14 Po aty, neni 5ç
- 15 Po aty, neni 13/3
- 16 Ligji Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, neni 5
- 17 Ligji Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, neni 44

## 2.2 Kuadri institucional për të drejtën e informimit dhe roli i OSHC-ve vendore

Figura 1. Aktorët që përfshihen në procesin e monitorimit të transparencës në nivel vendor



Aktorët që përfshihen në procesin e monitorimit të transparencës në nivel vendor janë si më poshtë:

- 1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** është institucioni publik, i cili njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas Ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit “Për njoftim dhe konsultim publik” apo që lidhen me çështjen në shqyrtim. Komisioneri sipas rastit u propozon bashkive përgjegjëse rekomandime apo dhe masa administrative përkatëse.
- 2. Këshilli Bashkiak** si organi përfaqësues i bashkisë mbikëqyr informimin e publikut nga administrata e bashkisë; është përgjegjës për zhvillimin e

seancave të këshillimit me publikun dhe konsultimeve; mbikëqyr garantimin e pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes; Gjithashtu, Këshilli Bashkiak është organi që miraton Programin e Transparencës së bashkisë dhe informacionin përkatës sipas fushave të tij dhe si i tillë mund të ndër marrë nisma apo mekanizma për monitorimin e zbatimit të tij nga administrata e bashkisë.

- 3. Kryetari i Bashkisë**, si organi ekzekutiv i bashkisë dhe titullari i institucionit, mbikëqyr procesin e zbatimit të Programit të Transparencës nga ana e administratës së bashkisë dhe njësisë administrative e të varësisë.
- 4. Aktorët jopublikë**, ku përfshihen organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupe të ndryshme interesi, kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës të jashtëm të zbatimit të Programit të Transparencës. Këta aktorë, nëpërmjet veprimtarisë së tyre monitoruese, i nxisin njësitë e vetëqeverisjes vendore të përmirësojnë transparencën duke u kërkuar atyre më shumë llogaridhënie. Roli i aktorëve jopublike ka dëshmuar të jetë veçanërisht i rëndësishëm gjatë periudhave të emergjencave, duke i shërbyer jo vetëm monitorimit por edhe kërkesës për përgjegjshmëri më të lartë të vendimmarrësve vendore, veçanërisht në rastet e nevojave emergjente të qytetarëve, si p.sh., rasti i tërmetit apo komuniteteve në nevojë në rastin e pandemisë<sup>18</sup> për të siguruar ndihmë humanitare dhe shërbime, fushata për mbledhjen e fondeve, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin për problematika të ndryshme nëpërmjet denoncimit publik.

••••

18 Bino, B. Xhaferaj, O. Lula, L. (2020) "Roli i shoqërisë civile dhe medias në menaxhimin e krizave në Shqipëri" <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/12/Roli-i-Shoq-civ-media-final.pdf>

### 3. Aksesit në informacion: Jetik për demokracinë vendore dhe fuqizimin e qytetarëve

Bashkitë, si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve dhe si ofrues të shërbimeve publike në nivel vendor, kanë një rol thelbësor në informimin publik dhe mundësimin e vendimmarrjes vendore me pjesëmarrje. Qasja në informacion publik i fuqizon qytetarët për të kërkuar të drejtat e tyre, për të ndërmarrë veprime apo për të bërë zgjedhje të informuara dhe për tu bërë qytetarë më të përgjegjshëm e të angazhuar. Nga ana tjetër, aksesit në informacion krijon kushtet e përshtatshme për qytetarët dhe shoqërinë civile që të jenë më të ndërgjegjshëm për rolin mbikëqyrës që kanë ndaj qeverisjes, duke nxitur kështu pjesëmarrjen e informuar publike në vendimmarrje, duke krijuar kushtet për një qeverisje të hapur dhe duke garantuar më shumë transparencë dhe llogaridhënie.

E drejta e informimit lidhet ngushtë me lirinë e fjalës dhe të dyja janë jetike për një demokraci funksionale. Në të drejtën ndërkombëtare, liria e informimit është pjesë përbërëse e lirisë së fjalës, e cila është e drejtë themelore e njeriut, e përkufizuar si “liria e shprehjes”, dhe përfshin të gjitha format e shprehjes: me gojë, me shkrim, në median e shtypur, përmes internetit apo përmes formave të ndryshme të arteve pamore. Kjo do të thotë se mbrojtja e lirisë së fjalës si një e drejtë përfshin jo vetëm përmbajtjen, por edhe mjetet dhe mënyrat e shprehjes. Prandaj, liria e shprehjes nuk kuptohet pa lirinë e informimit, pasi shprehja dhe informimi janë dy anët e një komunikimi publik” (Matlija 2015, 7).<sup>19</sup>

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritete publike, mbartin detyrimin e garantimit të së drejtës për informim si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre. Qasja e publikut në informacion është hapi i parë drejt transparencës dhe llogaridhënies dhe është baza për ndërtimin e besimit të publikut tek institucionet vendore.<sup>20</sup> Nga ana tjetër, rritja e besimit publik në qeverisje

....

19 Matlija, D. (2015). Komentari i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” së bashku me praktikën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

20 Diba, B. (2016). Udhëzues informativ ligjor. E drejta për informim në Shqipëri. Shkodër: Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë”.



krijon më shumë gjasa për një komunikim të hapur dhe sinergji më të madhe mes qeverisjes vendore dhe qytetarëve. Disa nga mënyrat më efektive për ta realizuar këtë janë prania sa më afër publikut nëpërmjet zyrave të informimit qytetar, publikimit proaktiv të informacionit në PT apo shfrytëzimit të rrjeteve sociale për informuar qytetarët për çështje të ndryshme.

Monitorimi i transparencës nga aktorë jopublikë është i rëndësishëm, pasi rrit ndjeshmërinë ndaj problematikave të zbatimit të së drejtës për informim si dhe nxit bashkitë të përmirësojnë punën e tyre dhe llogaridhënien. Monitorimi i transparencës merr një rëndësi të veçantë kryesisht gjatë situatave të emergjencave apo fatkeqësive natyrore, gjatë të cilave shumë të drejta të qytetarëve kufizohen. Gjatë situatave të emergjencës, monitorimi i transparencës vendore nga aktorë të ndryshëm ndikon pozitivisht për dy arsye: së pari, krijon presionin e nevojshëm që njësitë e vetëqeverisjes vendore të jenë më të përgjegjshme për të publikuar çdo procedurë për të ruajtur besimin e publikut; dhe, së dyti, për sa i përket menaxhimit të fondeve publike,<sup>21</sup> pasi gjatë periudhave të tilla procedurat e prokurimeve publike janë më të shumta.

### 3.1. Monitorimi i të drejtës së informimit nga aktorët jopublikë

Njësitë e qeverisjes vendore kanë qenë objekt i monitorimeve të ndryshme, si transparenca, cilësia e shërbimeve apo mbikëqyrja e vendimmarrjes, etj., të cilat janë realizuar në pjesën më të madhe nga aktorë të shoqërisë civile. Këto monitorime kanë nxjerrë në pah performancën e njësive vendore dhe arritjet e tyre, por njëkohësisht edhe sfidat dhe pengesat e hasura, duke i krahasuar ato me standardet e kërkuara. Një pjesë e mirë e tyre kanë ofruar një qasje krahasuese të bashkive në lidhje me nivelin e transparencës.

Sipas raportit të monitorimit "Pushteti Vendor nën Lentën e të Drejtës për Informim" përgatitur nga BIRN Albania, nga vlerësimi krahasues i treguesit të transparencës në terren dhe online për 61 bashkitë e vendit për vitin 2019, Bashkia Shkodër renditej e para në listë me nivel transparence proaktive online 74%. Edhe pse gjatë monitorimit online rezultoi se numri i bashkive që kanë një faqe zyrtare interneti është rritur nga 40 në 2017 në 61 në 2019, duke përfshirë të gjithë njësitë e qeverisjes vendore në vend, transparenca mesatare e faqeve të monitoruara në vitin 2019 ka shënuar një rënie në krahasim me dy vjet më parë.<sup>22</sup> I njëjti raport e rendit Bashkinë Berat në vendin e 54,

....

- 21 Shehaj, A. dhe Totoni, L. (2021). Udhëzues për monitorimin qytetar të transparencës dhe llogaridhënies për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
- 22 <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2019/05/Pushteti-vendor-single-page-web-1.pdf>; <https://www.monitor.al/bashkite-bejne-hapa-pas-ne-nivelin-e-transparences-proaktive/>

duke e vlerësuar si një ndër bashkitë me nivel të ulët transparence nga monitorimi në terren (29%), ndërsa Bashkinë Mat në vendin e 61, duke e vlerësuar si bashkitë me nivelin më të ulët të transparencës online (8%).

Bazuar në raportin kombëtar të monitorimit të kryer nga BIRN për vitin 2016 – 2017, “Pushteti Vendor nën Lentën e të Drejtës për Informim”, Bashkia e Korçës renditet e para ndër të gjitha bashkitë për vitin 2017, me një nivel të transparencës prej 69% (BIRN, 2017).<sup>23</sup> Kategoritë më transparente në Bashkinë e Korçës janë transparenca financiare, zbatimi i së drejtës për informim dhe publikimi i mbledhjeve dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak. Për sa i përket nivelit të përgjithshëm të transparencës së 61 bashkive të monitoruara, në vendin e dytë renditej bashkia Shkodër, ndërkohë që bashkia Vlorë dhe Berat renditeshin në fund të listës për 2017. Gjithashtu, në raport vihet re se midis vitit 2016 dhe vitit 2017 ka pasur një rritje në 26% të nivelit të transparencës për Bashkinë Tiranë, thuajse në të gjithë fushat e Programit të Transparencës. Ndërkohë që një ndër fushat e cila vijon të mbetet dhe në vitin 2017 me nivel të ulët të transparencës është transparenca financiare e Bashkisë Tiranë.

Qendra Res Publica, si një nga organizatat më aktive në fushën e të drejtës së informimit, ka publikuar vazhdimisht që prej 2015 raporte monitorimi për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Në raportin e 2019 “E drejta e Informimit 2019” prezantohen rezultatet e performancës së 100 autoriteteve publike, lidhur me plotësimin dhe përditësimin e programeve të transparencës, publikimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit për kërkesat dhe përgjigjet, sjelljen e institucioneve ndaj kërkesave për informacion, etj., gjatë vitit 2019.<sup>24</sup> Përshtatja e programit të transparencës së bashkive si nismë e Komisionerit përmendet si një praktikë pozitive që duhet të ndiqet edhe nga institucionet e tjera. Ndonëse bashkitë e kanë detyrim miratimin e PT-së sipas modelit të Komisionerit, nga monitorimi i kryer nga Res Publica rezultoi se më pak se gjysma e tyre e kanë zbatuar këtë vendim. Ndër 100 institucionet e monitoruara, Bashkia Shkodër vlerësohet se ka realizuar një program transparence të plotë sipas standardeve të kërkuara.

Qendra Res Publica ka publikuar në shtator 2019 një raport kombëtar për Indeks të Transparencës së Pushtetit Vendor, i cili që ka për qëllim analizën e transparencës dhe identifikimin e shembujve pozitivë dhe ato negativë lidhur me nivelin e transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas të dhënave të raportit, rezulton

....

23 BIRN Albania. (2017) Monitorimi 2017 - Pushteti vendor nën lentën e të drejtës për informim <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2016/10/Pushteti-vendor-nen-lenten-e-te-drejtjes-per-informim.pdf>

24 Matlija, D., dhe Dule, I. (2019). E drejta e Informimit 2019. Kur Komisioneri për të Drejtën e Informimit reduktohet në monitorues.... Tiranë: Qendra “Res Publica” <http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2020/01/E-drejta-e-informimit-2019-Res-Publica-web.pdf>

se Bashkia e Shkodrës renditet e para ndër të gjitha bashkitë për vitin 2019 me një nivel të pikëve prej 86 (Publeaks, 2019).<sup>25</sup> Kategoritë më transparente në Bashkinë e Shkodrës janë transparenca financiare, zbatimi i së drejtës për informim dhe publikimi i mbledhjeve dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.<sup>26</sup>

Një studim tjetër i realizuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP (2018), për zbatimin e Ligjit Nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, në nivel të qeverisjes vendore, vlerësohet Programi i Transparencës i Bashkisë Shkodër si një ndër programet më të mira në Shqipëri për vitin 2018 pas Bashkisë Korçë. Bashkia Gjirokastër është vlerësuar si një ndër bashkitë me ecuri të ngadaltë në lidhje me zbatimin korrekt të kuadrit ligjor rregullator për aksesin në informacion.<sup>27</sup> I njëjti raport monitorimi realizuar nga INFOÇIP në 2017 e ka vlerësuar Bashkinë Korçë si një ndër bashkitë më transparente në Shqipëri për vitin 2017, bazuar në pesë tregues 1) Pasja e një faqe zyrtare interneti; 2) Regjistri i pyetjeve dhe përgjigjeve; 3) Koordinatori për të drejtën e informimit; 4) Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak; 5) Hartimi dhe publikimi i Programit të Transparencës (INFOÇIP, 2017).<sup>28</sup>

Gjithashtu, Udhëzuesi për Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare në Shqipëri, hartuar nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe organizata Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (2018) e kategorizon Bashkinë Korçë si një ndër bashkitë më progresive dhe shembull i praktikave të mira për zbatimin korrekt të kuadrit rregullator në lidhje me aksesin në informacion. Disa nga kategoritë më transparente në Bashkinë e Korçës janë transparenca financiare, zbatimi i së drejtës për informim dhe publikimi i mbledhjeve dhe vendimeve të këshillit bashkiak. Bashkia Fier vlerësohet si një ndër bashkitë me praktikën më të mirë në lidhje me analizën e sistemit të menaxhimit të financave publike. I njëjti studim e vlerëson Bashkinë e Elbasanit si një ndër bashkitë më progresive në lidhje me praktikat e mira për procesin e zbatimit të buxhetimit me pjesëmarrje. Bashkia e Elbasanit renditet si një nga bashkitë e para që kanë zbatuar buxhetimin me pjesëmarrje që nga viti 2004.<sup>29</sup>

....

- 25 Publeaks 2019. Gara e Transparencës <https://www.publeaks.al/renditja-e-institucioneve/>
- 26 Qendra Res Publica (2019). Monitorimi 2018-2019-indeksi i Transparencës, pjesë e projektit “Rritja e aksesit të gazetarëve investigues në informacionin zyrtar”
- 27 INFOCIP (2019). Monitorimi 2019-Implementimi i të drejtës së informimit nga bashkitë e Shqipërisë. Tiranë; <https://www.infocip.org/al/wp-content/uploads/2018/09/Monitorimi-INFOCIP-2018-E-DREJTA-E-INFORMIMITNE-61BASHKI.pdf>
- 28 INFOCIP 2017 Monitorimi 2017-Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë. Tiranë
- 29 SHQIPËRIA Udhëzues mbi Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare.2018

Organizata Civil Rights Defenders publikoi në 2021 raportin rajonal me fokus Ballkanin Perëndimor “Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut”,<sup>30</sup> ku përfshihej edhe Shqipëria. Ndër të tjera, ky raport thekson nevojën e institucioneve të pavarura në Shqipëri, ndër to edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të përmirësuar efektivitetin e veprimtarisë së tyre, duke punuar për zbatueshmëri më të lartë të rekomandimeve nëpërmjet ndjekjes sistematike të rasteve, hartimit të strategjive institucionale të komunikimit, nisjes së hulumtimeve për çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut, përshtatjes së formateve të kërkesave dhe ankesave për persona me nevoja të veçanta, etj.

Studime dhe monitorime të tjera janë kryer gjatë periudhës 2019-2020, kur Shqipëri u përball me dy situata fatkeqësive natyrore, tërmetin e nëntorit 2019 dhe pandeminë COVID-19 në 2020. Këto studime kanë rëndësi të veçantë, pasi transparencja dhe informacioni marrin vlerë të shtuar në kohë krizash dhe është shumë e rëndësishme që gazetarët, mjekët, aktivistët e shoqërisë civile dhe qytetarët në përgjithësi të jenë në gjendje të kritikojnë autoritetet dhe të monitorojnë përgjigjen e tyre ndaj krizës. Sipas raporteve të shoqërisë civile, institucionet e ulën transparencën pas tërmetit dhe gjatë pandemisë COVID-19. Ato punuan me staf të reduktuar dhe shpesh nuk patën infrastrukturën e nevojshme për t’ju përgjigjur situatës së krijuar. Sipas Portës Vendore<sup>31</sup> bashkitë si Durrësi, Tirana, Kruja apo institucionet si Ministria e Brendshme dhe ajo e Arsimit nuk iu përgjigjën kërkesave për informacion gjatë periudhës që pasoi tërmetin e nëntorit 2019, duke lënë pa përgjigje pyetje me interes publik. Ndërsa sipas raportit të Qendrës Res Publica “E drejta e informimit gjatë fatkeqësive natyrore në Shqipëri”, gjatë vitit 2020 transparencja reaktive ka rënë me 15%, informacioni i dhënë gjatë pandemisë ka qenë kryesisht i centralizuar nga qeveria<sup>32</sup> dhe, për rrjedhojë, mundësitë e medias dhe organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar kanë qenë të kufizuara.

Në lidhje me transparencën e përgjithshme të institucioneve gjatë pandemisë, në monitorimin e bërë nga Bashki të Forta vlerësohet praktika e disa bashkive për

....

- 30 Xhaho, A. (2021) “Effectiveness of NHRIs WB Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo” Civil Right Defenders.
- 31 Emiri, G. (2020) “Institucionet ulën transparencën dhe kufizuan informacionet pas tërmetit dhe gjatë pandemisë së COVID-19” Aksuar tek Porta Vendore <https://portavendore.al/2020/07/19/institucionet-ulen-transparencen-dhe-kufizuan-informacionet-pas-termetit-dhe-gjate-pandemise-se-covid-19/>
- 32 Matlija, D. (2021) “E drejta e informimit gjatë fatkeqësive natyrore në Shqipëri”, Civil Rights Defenders

transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak<sup>33</sup>. Gjithsesi, nga ana tjetër, kjo ka munguar në bashkinë më të madhe në vend, atë të Tiranës.<sup>34</sup> Sipas monitorimit të kryer nga Qëndresa Qytetare<sup>35</sup>, këto vendime të Bashkisë Tiranë janë marrë pa zhvilluar konsultime me qytetarët dhe projekt-vendimet nuk janë publikuar para miratimit sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Së fundmi, sipas raportit “Vlerësimi i të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës teksa Shqipëria kryeson OSBE”, institucionet qendrore më të rëndësishme në menaxhimin e situatës së pandemisë, nuk kanë qenë transparente dhe e kanë bërë të vështirë që gazetarët/organizatat e shoqërisë civile të monitorojnë, kontrollojnë faktet apo të investigojnë veprimtarinë e tyre.<sup>36</sup>

••••

- 33 Bashki të Forta (2020) “Për një qeverisje funksionale në përgjigje të sfidës covid-19 në bashkëpunim me komunitetet vendore” <http://bashkiteforta.al/wp-content/uploads/2020/06/Raporti-Javor-19Maj-3Qershor.pdf>
- 34 Gjerani, E. (2020) “Transparenca e bashkive gjatë Pandemisë – Presioni i shoqërisë civile dhe medias lokale dhe efektet e saj”, aksesuar tek Porta Vendore <https://portavendore.al/2020/08/07/transparenca-e-bashkive-gjate-pandemise-presioni-i-shoqerise-civile-dhe-medias-lokale-dhe-efektet-e-saj/>
- 35 Qëndresa Qytetare (2020) “Raport informues: Vendimmarrja e Këshillit Bashkiak Tiranë gjatë situatës së COVID” <https://qytetarin.com/wp-content/uploads/2020/06/final.pdf>
- 36 Krasniqi, A. Metalla, A. Bozo, A. Likmeta, B. Skendaj, E. Cukaj, I. Voko, K. Reçi, M. Shehu, R. (2021) “Vlerësimi i të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës teksa Shqipëria kryeson OSBE” <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/01/Vleresimi-i-te-Drejtave-te-Njeriut-dhe-Shtetit-te-se-Drejtës-teksa-Shqiperia-kryeson-OSBE-ne.pdf>

## 4. Metodologjia

Ky raport monitorimi ofron një qasje krahasimore të transparencës proaktive të 12 bashkive qendër qarku, përmes monitorimit të Programit të Transparencës të publikuar në faqet e internetit. Instrumenti bazë për monitorimin e Programit të Transparencës është Sistemi i Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies i hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit “Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale – STAR 2”. Ai shoqëron Programin e Transparencës së bashkive dhe lehtëson ofrimin e dhënies së informacionit me interes publik në kohë dhe mënyrë efektive, duke kontribuar në zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Sistemi i matjes ka për qëllim të realizojë një vlerësimin objektiv të të gjithë informacionit/dokumentacionit që duhet të publikohet në Programin e Transparencës, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të grupuar në shtatë fusha kryesore. Për secilën prej fushave të mësipërme është detajuar lista e dokumenteve si dhe baza ligjore e rregullatore përkatëse. Në mënyrë të detajuar lista e dokumentacionit që duhet të publikohet në Programin e Transparencës gjendet në Shtojcën 3. Secila fushë është ndarë në disa nënfusha në përmbajtje të të cilave janë treguesit përkatës. Treguesit janë përzgjedhur duke u bazuar në përgjegjësitë, kompetencat, funksionet, dhe procedurat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore që përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi. Në total, për 7 fushat ka 147 tregues, që kanë të gjithë të njëjtën peshë. Duhet theksuar se Programi i Transparencës mund të rishikohet një herë në pesë vjet, ndërsa përditësimi i tij duhet të bëhet rregullisht.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i treguesve dhe pikëve për secilën nga 7 fushat e Programit të Transparencës:

**Tabela 1. Numri i treguesve dhe pikëve për 7 fushat e programit të transparencës**

Fusha	Nënfusha	Tregues	Pikë
I: Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë	4	32	64
II: Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare	10	29	58
III: Kërkesat për informim	8	23	46

Fusha	Nënfusha	Tregues	Pikë
IV: Shërbimet që ofron bashkia	3	15	30
V: Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore	1	6	12
VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje	9	32	64
VII: Informacion tjetër	4	10	20

Secili tregues paraqet një dokument apo informacion që duhet të publikohet nga bashkitë dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm për qytetarët. Gjithashtu, treguesit synojnë të matin nivelin e transparencës së bashkive si dhe të shërbejnë për të vlerësuar gatishmërinë e zyrtarëve vendorë për të qenë të hapur ndaj qytetarëve dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje. Çdo tregues mund të vlerësohet me 0, 1 dhe 2 pikë, në bazë të sasisë dhe cilësisë së informacionit që rezulton në lidhje me të nga monitorimi. Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki. Duke përdorur tabelën e shkallëzuar në kuantile të Sistemit të Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies bëhet specifikimi relativ i shkallës së transparencës dhe llogaridhënies në njësinë përkatëse. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur një ndarje e niveleve të transparencës në 5 grupime të mëdha: 1. Transparencë e ulët; 2. Transparencë pjesërisht e ulët; 3. Transparencë mesatare; 4. Transparencë pjesërisht e lartë; 5. Transparencë e lartë.

**Tabela nr. 2: Kategoritë e transparencës**

Pikët totale	Kuantilet në bazë të pikëve totale	Kategoria e performancës
Kuantil 1 (0-59 pikë)	0-20%	Transparencë e ulët
Kuantil 2 (60-118 pikë)	20-40%	Transparencë pjesërisht e ulët
Kuantil 3 (119-177 pikë)	40-60%	Transparencë mesatare
Kuantil 4 (178-235 pikë)	60-80%	Transparencë pjesërisht e lartë
Kuantil 5 (236-294 pikë)	80-100%	Transparencë e lartë

Edhe pse nisma në fjalë për monitorimin e transparencës dhe llogaridhënies, përmes përdorimit të një sistemi të unifikuar siç është sistemi i matjes së TLL (Transparencës dhe Llogaridhënies), synon të përhapet gjerësisht edhe në bashkitë e tjera, duhet të kemi parasysh që instrumenti vlerëson vetëm transparencën proaktive të institucionit. Ky lloj vlerësimi nuk merr përsipër të vlerësojë transparencën në terren apo shkallën e gatishmërisë së bashkive (kohëzgjatjen, ndërveprimin me institucionin, etj.) për të dhënë informacion përmes kërkesave për informim (informimi aktiv). Për një qasje më gjithëpërfshirëse të vlerësimit të TLL në tërësi, sugjerohet edhe vlerësimi i transparencës reaguese, pasi ajo ofron pamjen më të gjerë dhe të plotë të hapjes së institucionit ndaj publikut. Ky ushtrim nuk i shërben vetëm bashkisë por edhe aktorëve të shoqërisë civile, të cilët kanë rol kryesor në nxitjen e nismave të ngjashme që promovojnë transparencën dhe llogaridhënien në nivel vendor.

Një tjetër implikim i metodologjisë është përzgjedhja e kampionit të bashkive, i cili bazohet në përzgjedhjen e 12 bashkive qendër qarku dhe jo me tregues të tjerë si p.sh., madhësia e bashkisë.

Nga 12 bashkitë e monitoruara në total, dy bashki (Bashkia Gjirokastër dhe Bashkia Berat) nuk kanë të publikuar në faqen e tyre në internet një Program Transparence sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën për Informim. Megjithatë, ekspertët e monitorimit kanë vlerësuar nivelin e transparencës së informacionit të publikuar online në uebfaqen e bashkisë. Në shtojcën 1 të këtij studimi jepet një analizë e përmbledhur e monitorimit të transparencës online të këtyre dy bashkive.




## 5. Raportimi i gjetjeve

Çdo autoritet publik është i detyruar sipas Ligjit “Për të drejtën e Informimit” të publikojë pa kërkesë në faqen e tij të internetit një numër të konsiderueshëm kategorish informacioni duke i publikuar në rubrikën “Programi i Transparencës” (PT). Me anë të publikimit të informacionit në PT, autoritetet vendore duhet të marrin në konsideratë interesin më të lartë të komunitetit, veçanërisht për të siguruar akses maksimal në informacionin në dispozicion të publikut, dhe të bëjnë publik sa më shumë informacion që të jetë e mundur në mënyrë që të bie nevoja për kërkesa individuale për informacion. Informacioni duhet të jetë në format lehtësisht të kuptueshëm dhe i aksesueshëm dhe të organizohet sipas kategorive të informacionit të përcaktuar në ligj.

Nga 12 bashki të monitoruara në total, vetëm 10 prej tyre kishin miratuar dhe bërë publik një Program Transparence sipas modelit të miratuar nga Komisioneri. Dy bashkitë që nuk kishin publikuar një Program Transparence, Bashkitë Berat dhe Gjirokastër, u monitoruan vetëm për informacionet e publikuara në faqet e tyre në internet. Për këtë arsye, gjetjet nga këto dy monitorime do të analizohen veçmas në Shtojcën 1.

Në bashki të ndryshme, Programi i Transparencës është i paraqitur në forma të ndryshme. Në disa bashki, si p.sh., Shkodra, Dibra apo Vlora, PT është vendosur në një rubrikë të posaçme, lehtësisht të dallueshme sapo klikohet në faqen kryesore të bashkisë. Ndërkohë, vendosja e një tabele me përmbajtje automatike sapo klikohet rubrika, si në rastin e Dibrës, e lehtëson kërkimin e informacionit. Është pozitiv fakti që në një pjesë të mirë të bashkive informacioni i publikuar është i aksesueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm, pasi mund të kopjohet, përpunohet (kur është në Word) shkarkohet dhe të printohet. Një tjetër element pozitiv i konstatuar është publikimi i broshurave në lidhje me informimin në distancë në kushtet e pandemisë Covid-19, si në rastin e Bashkisë Shkodër apo vendosja e një mesazhi me këshilla anti-Covid që shfaqet automatikisht në ekran sapo futesh në faqen ueb të Bashkisë Tiranë. Përveç kësaj, Bashkia Tiranë ka një rubrikë të posaçme për emergjencat civile me këshilla për rastet e tërmeteve dhe përmbajtjeve si dhe një rubrikë të posaçme me përditësime rreth situatës së pandemisë Covid-19. Nga ana tjetër, Bashkia Durrës ka shfaqur në krye të faqes numrat e kontaktit për qytetarët që kanë nevojë për ndihmë në lidhje me Covid-19. Është për t’u vlerësuar fakti që këto informacione, edhe pse nuk janë të detyrueshme, janë publikuar me nismë nga vetë bashkitë për t’iu përgjigjur nevojave dhe shqetësimeve më aktuale të qytetarëve që lidhen me situatat e emergjencave që ka kaluar vendi.

FIGURA 2  
RENDITJA E BASHKIVE SIPAS  
PËRQINDJES SË TRANSPARENÇËS




Përveç mënyrës së paraqitjes, edhe mënyra e organizimit të PT ndryshon nga një bashki në tjetrën. P.sh., në Bashkinë e Korçës gjenden të mirë organizuara të gjithë rubrikat dhe nënrubrikat e PT-së, ndërkohë që ka bashki që e kanë vendosur PT si nënrubrikë në rubrika të tjera me emra të ndryshëm. Për shembull në rastin e bashkive Elbasan dhe Fier, PT gjendet nën rubrikën “Shërbimet”, në bashkitë Kukës dhe Tiranë gjendet nën një rubrikë që quhet “Zëri yt” dhe në Bashkinë Durrës PT gjendet në një rubrikë që quhet “Qyteti dhe qytetarët”. Mungesa e një modeli të unifikuar e vështirëson gjetjen e informacionit për qytetarët që nuk mund të orientohen shumë mirë në faqet ueb. Problematikë tjetër është që një pjesë e rubrikave për informacion ekzistojnë vetëm si tituj dhe rezultojnë pa informacion kur klikohen, p.sh në Bashkinë Kukës.

Nga monitorimi i dokumentacionit të publikuar në Programin e Transparencës në 10 bashki të vendit rezultoi që një bashki i përket kategorisë “Transparencë e ulët” (Kukës), një prej tyre i përket kategorisë “Transparencë pjesërisht e ulët” (Vlorë), katër prej tyre i përkasin kategorisë “Transparencë mesatare” (Dibër, Lezhë, Tiranë, Elbasan), tre bashki i përkasin kategorisë “Transparencë pjesërisht e lartë” (Durrës, Korçë, Fier) dhe vetëm një bashki i përket kategorisë “Transparencë e lartë” (Shkodër). Bashkia me numrin më të lartë të pikëve është Bashkia Shkodër, ndërsa ajo me numrin më të ulët të pikëve është Bashkia Kukës.

## » *Fusha I - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë*

Për vlerësimin e fushës së parë “Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë” janë monitoruar 4 nënfusha me 32 tregues. Informacioni në këtë fushë nuk është i natyrës sensitive dhe i shërben qytetarit për të njohur më mirë institucionin e bashkisë, mënyrën se si është e organizuar nga pikëpamja administrative-territoriale por edhe në nivel të brendshëm, duke i ofruar informacion për kompetencat dhe detyrat e organeve të bashkisë dhe administratës, punonjësit etj. Një element shumë i rëndësishëm i kësaj fushe është informacioni që i lejon qytetarët dhe grupet e interesit të ndjekin dhe monitorojë veprimtarinë vendimmarrëse të organeve të bashkisë, p.sh., duke pasur akses tek projekt-vendimet e Këshillit Bashkiak para miratimit, kalendari i mbledhjeve, rendi i ditës, etj. Përveç këtyre, kjo fushë është me rëndësi edhe për aspektin praktik dhe orientues të saj, i cili përfshin oraret e pritjes për qytetarët, adresat postare apo elektronike të institucionit apo procedurën e depozitimit të kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve. Këto të fundit janë të rëndësishme për raportimin e veprimeve apo praktika të dyshuara të korrupsionit.

FIGURA 3  
FUSHA I - PËR ORGANIZIMIN  
DHE FUNKSIONIMIN E BASHKISË



Në këtë fushë, shumica e bashkive, me në krye atë të Durrësit, kanë vënë në dispozicion informacione në nivel pjesërisht të lartë. Nga ana tjetër, janë bashkitë Kukës dhe Vlorë të cilat bien në sy për nivelin më të ulët të pikëve në këtë fushë. Në Bashkinë e Kukësit mungojnë edhe informacione bazike, të tilla si të dhëna për ndarjen administrativo-territoriale të bashkisë apo detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, ndërsa në Vlorë, ndër të tjera mungojnë të gjithë treguesit e nënfushës për organizimin dhe funksionimin e bashkisë.

Niveli mesatar i transparencës për të 10 bashkitë e monitoruara është 64.1%, ose transparencë pjesërisht e lartë. Kjo është fusha e tretë më transparente për bashkitë e monitoruara.

Në **nënfushën e parë “Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet”**, është pozitive që shumica e bashkive (8/10) kanë shënuar maksimumin e pikëve, përveç Bashkisë së Kukësit, ku informacioni mungon plotësisht dhe Bashkisë Fier, e cila në këtë fushë nuk e ka të plotë informacionin mbi detyrat e njësive administrative.

**Edhe në nënfushën e dytë “Organet e Bashkisë”**, Bashkia e Durrësit ka shënuar numrin maksimal të pikëve, ndërsa bashkitë Vlorë dhe Kukës kanë pikë minimale. Në nivel të lartë pikësh në këtë fushë shfaqen edhe bashkitë Korçë, Lezhë, Elbasan. Është pozitiv fakti që disa bashki e kanë organizuar informacionin në disa seksione si qyteti, njësitë apo rajonet dhe kanë paraqitur një organogramë të mirëstrukturuar, si dhe kanë mundur që dokumentet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme. Ndërsa disa problematika që janë vënë re kanë të bëjnë me mungesën lidhjeve/adresave apo vendosjen e tyre por të papërditësuara, si dhe me paraqitjen e informacionit në gjuhë të vështirë teknike që nuk është e kuptueshme për këdo. Tre treguesit e parë në lidhje me këshillin bashkiak, përbërja dhe strukturat, detyrat dhe kompetencat si dhe rregullorja, janë të plotësuar me informacion në shumicën e bashkive përveç bashkive Kukës dhe Vlorë, ku këto mungojnë ose nuk janë të plota dhe Bashkisë Fier ku informacioni për rregulloren nuk është i plotë. Bashkitë e tjera kanë maksimumin e pikëve në këto 3 tregues.

Gjithsesi, situata nuk paraqitet po aq pozitive kur bëhet fjalë për treguesit pasues të cilët janë më të rëndësishëm dhe lidhen me mundësinë për t'u informuar paraprakisht për veprimtarinë vendimmarrëse të këshillit bashkiak. Kalandari i mbledhjeve të këtij këshilli nuk është i publikuar në gjysmën e bashkive, ndërsa vetëm 4 bashki kanë informacion të plotë. Njoftimet e mbledhjeve të këshillit bashkiak janë të plota vetëm në bashkitë Durrës, Lezhë dhe Fier, ndërsa në të gjithë bashkitë e tjera ky informacion mungon ose është i paplotë. Në Bashkinë e Dibrës, informacionet për mbledhjet e këshillit bashkiak apo rendin e ditës publikohen në kanale të tjera si p.sh., Facebook, por kjo nuk e përjashton bashkinë nga detyrimi për ta publikuar këtë informacion në Programin e Transparencës. Informacioni për rendin e ditës mungon në pjesën dërrmuese të bashkive (7/10), është i plotë vetëm në bashkitë Lezhë dhe Durrës, dhe i pjesshëm në Bashkinë e Fierit. Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga

këshilli bashkiak janë të publikuara vetëm në 4 bashki (Shkodër, Durrës, Lezhë, Korçë) dhe mungojnë në të gjithë të tjerat. Edhe publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak shfaqet problematik dhe është i plotë vetëm në 3/10 bashki. Kjo mungesë informacioni dhe transparence në shumicën e bashkive të monitoruara në lidhje me veprimtarinë vendimmarrëse të këshillit bashkiak duke përfshirë mbledhjet, rendin e ditës dhe projekt-vendimet e vështirëson dhe e kufizon mundësinë për monitorim dhe konsultim paraprak të grupeve të interesit dhe qytetarëve. Kjo praktikë e mospublikimit të projekt akteve bie ndesh me përcaktimet ligjore për vetëqeverisjen vendore, për të drejtën e informimit dhe atë të njoftimit dhe konsultimit publik.

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon që mbledhjet e këshillit bashkiak të jenë të hapura për publikun dhe njoftimi për mbledhjet të bëhet paraprakisht në një mënyrë sa më të aksesueshme.<sup>37</sup> Nga ana tjetër, mospublikimi i projekt-vendimeve për konsultim është në shkelje edhe të Ligjit Nr. 146/2014 “Për konsultimin publik” i cili kërkon që informacioni për projekt-aktet të bëhet publike në të gjitha fazat.<sup>38</sup> Nga ana tjetër, një tregues ku shumica e bashkive kanë performuar mirë është ai i publikimit të vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave me karakter normativ. Publikimi i tyre është i plotë në 8/10 bashki, ndërsa mungon plotësisht në bashkitë Kukës dhe Vlorë. Pra, duket që bashkitë zgjedhin t’i publikojnë vendimet e këshillave bashkiake vetëm kur janë përfundimtare dhe jo në fazën kur janë projekt-vendime dhe mund t’i nënshtrohen debatit dhe konsultimit publik. Mangësi paraqesin vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ të Kryetarit të Bashkisë, të cilët janë të publikuar plotësisht vetëm në gjysmën e bashkive të monitoruara. Ndërsa informacioni për procedurat e zgjedhjes së kryetarit të bashkisë mungon në 3 bashki, është i pa plotë në një bashki dhe i plotë tek bashkitë e tjera. Informacione të tjera në lidhje me kryetarin e bashkisë si detyrat dhe kompetencat (7/10) apo të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagën e kryetarit (6/10) janë të plota në shumicën e bashkive. Është shqetësuese që në 6 bashki mungon edhe një informacion parësor dhe orientues për publikun, siç është ai i orarit të pritjes për qytetarët. Situata është më pozitive sa i përket informacionit për adresën postare/elektronike, e cila mungon vetëm në 2 bashki.

**Në nënfushën e tretë “Administrata e bashkisë”** bashkitë me numrin më të lartë të pikëve janë Dibra dhe Fieri, ndërsa bashkitë me numrin më të ulët të pikëve janë Kukësi dhe Vlora. Informacioni për strukturën organizative dhe numrin punonjësve (9/10) dhe rregullorja e organizimit dhe funksionimit të administratës (8/10) janë publikuar të plotë në pjesën dërrmuese të bashkive. Sa i përket strukturës së pagave, 2/10 bashki nuk kanë fare informacion ndërsa 2/10 nuk e kanë informacionin të plotë. Detyrat e administratës së njësisve administrative janë të publikuara në mënyrë

....

37 Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17

38 Ligji Nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, neni 5

të plotë në 6 bashki. Problematik paraqitet edhe informacioni për organizimin dhe funksionimin e njësive në varësi, i cili në 3 bashki mungon plotësisht dhe në 3 të tjera është i paplotë. Bie në sy fakti që në këtë tregues ka shënuar 0 pikë edhe bashkia më transparente, ajo e Shkodrës. Njoftimi për vendet e lira të punës dhe procedurat e rekrutimit është i plotë vetëm në 6/10 bashki. Po ashtu, vetëm gjysma e bashkive kanë publikuar informacion të plotë për adresën postare dhe elektronike të zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive në varësi të saj. Ndërsa 4 bashki nuk kanë fare informacion të publikuar për drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë dhe 2 bashki e kanë informacionin të paplotë.

**Në nënfushën e katërt “Procedurat e bërjes së kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve lidhur me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës”** është pozitive që tre bashki kanë shënuar pikët maksimale, përkatësisht Durrësi, Elbasani dhe Korça. Ndërkohë bashkitë me performancën më të dobët këtu janë ajo e Vlorës, Tiranës, dhe Kukësit. Informacioni për procedurën për të bërë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe sinjalizime ndaj organeve të bashkisë është i plotë në një pjesë të konsiderueshme të bashkive (6/10), mungon plotësisht në bashkitë Kukës dhe Vlorë dhe është i pjesshëm në bashkitë Tiranë dhe Lezhë. Ky tregues ka shënuar pikën e vetme të Bashkisë Tiranë në këtë nënfushë dhe është për t’u theksuar që në praktikë informacioni (i pjesshëm) i dhënë në këtë rast për procedurën nuk i shërben publikut kur mungojnë të gjithë informacionet e tjera, dhe mbi të gjitha mungon adresa postare/elektronike ku duhet dërguar kërkesa/ankesa/vërejtja. Rregullorja e brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit është publikuar e plotë vetëm në 2/10 bashki, ndërkohë që informacioni për njësinë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet është i plotë vetëm në gjysmën e bashkive. Nga ana tjetër, 4 bashki nuk kanë publikuar adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve duke u mohuar qytetarëve mundësinë praktike për të dërguar një kërkesë apo ankesë, ndërsa 7 prej tyre kanë informacion të plotë ose të pjesshëm mbi afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet. Këta tregues janë shumë të rëndësishëm për të informuar qytetarët për mënyrën se si procedohet me kërkesat apo ankesat e tyre dhe, mbi të gjitha, janë të rëndësishëm për seriozitetin e procesit, nxitjen e besimit tek publiku dhe luftimin e korrupsionit. Zbatimi i Ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” në nivel kombëtar është jo i kënaqshëm. Në nivel vendor, zbatimi i tij përballet me sfida në rritje që lidhen me mungesën e besimit për ruajtjen e konfidencialitetit dhe frikën nga hakmarrja, pasi duke qenë se në komunitete të vogla njerëzit janë më të ekspozuar ndaj njëri-tjetrit, kjo ndikon në hezitimin e tyre për të sinjalizuar raste korruptive.<sup>39</sup> Mungesa e besimit të publikut, e shoqëruar edhe me

....

39 <https://ahc.org.al/sinjalizuesit-apo-bilbilfryresit-instrumenti-ligjor-i-pashfrytezuar/>

mungesë informacioni për këtë mekanizëm, mungesë që është e dukshme në bashkitë e monitoruara (si për qytetarët ashtu edhe për vetë punonjësit e bashkive<sup>40</sup>) si dhe vonesat në ngritjen e njësive të sinjalizimit në nivel vendor apo mungesa e akteve rregullatore rezultojnë në një numër të ulët raportimesh, gjë që dëshmohet edhe në monitorimet e kryera nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.<sup>41</sup>

Së fundmi, në këtë fushë bie në sy që informacioni jo sensitiv dhe teorik, si p.sh., struktura organizative, është vënë në dispozicion në nivel të lartë, ndërsa informacione që mund të paraqesin më shumë interes si mbledhjet e këshillit bashkiak, rregullorja për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, njësia përgjegjëse për sinjalizimet, janë të kufizuara. Gjithashtu, edhe informacionet praktike dhe thelbësore, si adresa postare/elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive në varësi të saj, nuk vihen në dispozicion në nivel të kënaqshëm.

## » *Fusha II - Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare*

Në fushën e dytë “Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare” janë monitoruar 10 nënfusha me 29 tregues. Informacioni në këtë fushë është shumë i rëndësishëm, pasi u mundëson qytetarëve të informohen për kapacitetet financiare të bashkisë së tyre, paketën fiskale të zbatueshme, planin e bashkisë për të përballuar vështirësi financiare, mënyrën si menaxhohen të ardhurat, nëse/sa nga këto të ardhura po përdoren për zhvillimin e qëndrueshëm, burimin e këtyre të ardhurave etj. Nga ana tjetër, publikimi i programit buxhetor afatmesëm vendor në të gjitha fazat e tij para miratimit është me shumë rëndësi që grupet e interesit të kenë mundësi të advokojnë për buxhetimin e duhur të një çështjeje/shërbimi të caktuar. Mbi të gjitha, transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare në përgjithësi, dhe sidomos në fushën e prokurimeve publike dhe menaxhimit të pronave dhe asetëve publike, janë kyçe në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor. Këto fusha mbartin ndërveprim me publikun dhe krijojnë mundësi për përfitime, favorizime dhe abuzime dhe mund të konsiderohen si “zona risku” në bashki. Risqet e korrupsionit mund të jenë të lidhura me procese të tilla si prokurimi publik ku ndërveprimi publik dhe privat është shumë i lartë, procesi i menaxhimit dhe administrimit të pronave publike, i cili përfshin tjetërsimin e pronës publike, procese me funksione menaxheriale si menaxhimi


....

40 Planet e integritetit të bashkive Durrës, Elbasan dhe Gjirokastrë.

41 Po aty.



FIGURA 4  
FUSHA II - TRANSPARENCA DHE  
LLOGARIDHËNIA  
EKONOMIKO-FINANCIARE



financiar, procesi i mbrojtjes së territorit nga ndërtimet pa leje etj. Transparenca në këto fusha do të ndikonte pozitivisht edhe në besimin e publikut. Shumica e dokumenteve në këtë fushë gjenden në formatin PDF, i cili lejon shkarkimin dhe kopjimin e informacionit. Megjithatë, shpesh vërehen dokumente voluminoze, që e vështirëson kërkimin e të dhënave.

Në vlerësimin e transparencës dhe llogaridhënies ekonomiko-financiare, disa bashki kanë shënuar një numër pikësh ndjeshëm më të ulët krahasuar me të tjerat, p.sh. Bashkia e Vlorës ka plotësuar vetëm 24% të treguesve, pasuar nga Bashkia e Kukësit me 36.2% dhe ajo e Tiranës me 47%. Është për t'u nënvizuar që Bashkia e Tiranës, ajo me buxhetin më të lartë<sup>42</sup>, renditet ndër më pak transparente sa i përket çështjeve ekonomiko-financiare. Ndërkohë Bashkia e Kukësit, edhe pse nivel pikësh të ulët, fusha e transparencës ekonomiko-financiare është fusha ku kjo bashki ka performuar më mirë se në të gjithë fushat e tjera. Bashkia më transparente në këtë fushë rezulton Bashkia Shkodër dhe duke u renditur pas saj bashkitë e Dibrës, Fierit dhe Korçës. Treguesit e kësaj fushe janë më teknikë se në fushën e parë, e për pasojë informacioni në Programin e Transparencës është më i komplikuar. Gjatë monitorimit janë vënë re dokumente që nuk janë përshtatur apo thjeshtuar për t'u kuptuar lehtësisht nga qytetarët.

Niveli mesatar i transparencës për këtë fushë për 10 bashkitë e monitoruara është 65%, ose transparencë pjesërisht e lartë. Kjo është fusha e dytë më transparente për bashkitë e monitoruara.

**Në nënfushën e parë “Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor”**, të gjithë bashkitë, përveç asaj të Kukësit kanë paraqitur informacion të plotë. Programi buxhetor afatmesëm është një proces shumë i rëndësishëm për bashkitë, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshëm për integrimin në procesin buxhetor të të cilave janë objektivat prioritare dhe strategjikë të institucionit. Publikimi i kalendarit vjetor për këtë proces është hapi i parë i informimit të qytetarëve, të cilët duhet të përfshihen më tej në konsultime nëpërmjet buxhetimit me pjesëmarrje për të shprehur prioritetet e tyre për shpenzimet publike.

**Në nënfushën e dytë “Paketa fiskale”** treguesi i bazës së taksave dhe tarifave është i plotë në të gjitha bashkitë, përveç Tiranës. Informacioni për nivelin e taksave dhe tarifave është i plotë në 8/10 bashki, ndërsa mungon në atë të Kukësit dhe Tiranës. Përjashtimet dhe lehtësimet për subjekte të veçanta janë të publikuara plotësisht në 7 bashki, ndërkohë që informacioni është i paplotë ose mungon tek bashkitë e tjera. Informacioni për afatet e pagesave mungon në 4/10 bashki dhe është i plotë tek të tjerat, ndërsa informacioni për gjokat dhe kamatëvonesat është i plotë vetëm në

....

42 Shih <http://financatvendore.al/buxhetet>

gjysmën e bashkive. Paraqitja e informacionit të paketës fiskale nuk përbën vështirësi për bashkitë dhe është në interesin e tyre që qytetarët të jenë të informuar dhe të shlyejnë rregullisht detyrimet e taksave dhe tarifave. Pavarësisht kësaj, shumë bashki kanë publikuar informacion të mangët në këtë nënfushë.

**Në nënfushën e tretë “Plani strategjik i zhvillimit të bashkisë”,** informacioni për politikën për zhvillimin e strategjik të bashkisë është i plotë në 7/10 bashki, ndërkohë që mungon në 3 të tjerat, duke përfshirë edhe Bashkinë e Shkodrës. Dy treguesit që lidhen me marrjen në konsideratë të nevojës dhe potencialeve të zhvillimit vendor (7/10) dhe paraqitjen e synimeve kryesore të fushave (8/10) janë të plotësuar në nivel të lartë. Identifikimi i veprimeve që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse dhe treguesit që burimeve të financimit janë të plota, vetëm në 6/10 bashki. Plani strategjik i zhvillimit të bashkisë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ekonomik, çështjet e mjedisit, përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve etj. Prandaj, është pozitiv fakti që treguesit e kësaj nënfushe janë plotësuar nga shumica e bashkive.

**Në nënfushën e katërt “Programi buxhetor afatmesëm vendor”,** është për t’u vlerësuar që gjysma e bashkive kanë shënuar numrin maksimal të pikëve (Shkodër, Dibër, Durrës, Fier, Korçë). Ndërsa bashkia Vlorë është vlerësuar me 0 pikë. Publikimi i këtij dokumenti në të gjitha fazat e hartimit dhe miratimit është shumë i rëndësishëm për konsultimin e publikut. Vihet re që bashkitë kanë qenë më të kujdesshme në publikimin e dokumentit fillestar dhe përfundimtar të PBA-së, dokument që mungon në vetëm 2/10 bashki, ndërsa dokumenti i rishikuar shfaqet më problematiku dhe mungon në 4/10 bashki. Për t’u nënvizuar është Bashkia Kukës, e cila ka publikuar vetëm dokumentin final dhe jo dokumentet në dy fazat e tjera të përgatitjes së tij.

Ndonëse në përgjithësi vihet re një dinamikë pozitive në publikimin e një informacioni të tillë nga bashkitë, gjuha teknike e përdorur dhe sasia e madhe e informacionit mund të vështirësojë marrjen e informacionit nga qytetarët që nuk janë të familjarizuar me terminologjinë e fushës. Për të lehtësuar aksesin e informacionit tek një kategori më e gjerë e publikut, rekomandohet që bashkitë të krijojnë mundësinë e paraqitjes së informacionit në mënyrë më interaktive. Këto platforma rrisin gjasat që bashkitë të jenë më transparente dhe gjithëpërfshirëse në vendimmarrje.<sup>43</sup>

....

43 Ndonëse disa bashki nuk janë subjekt vlerësimi në këtë proces monitorimi, ato kanë krijuar platforma më interaktive që mundësojnë përthithjen e një informacioni nga një kategori më e gjerë e qytetarëve. Psh. Bashkia Kolonjë: [https://public.tableau.com/profile/denalda.kuzumi#!/vizhome/Planning\\_Dashboard\\_Kolonje/Menu](https://public.tableau.com/profile/denalda.kuzumi#!/vizhome/Planning_Dashboard_Kolonje/Menu)

**Në nënfushën e pestë “Buxheti vjetor”**, bashkitë kanë performuar shumë mirë në shumicën e treguesve, ku gjysma e tyre kanë shënuar pikët maksimale. Bashkitë me numrin më të ulët të pikëve janë Vlora dhe Tirana me nga 4/10 pikë. Buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin është i publikuar në mënyrë të plotë në të gjitha bashkitë. Informacioni për treguesit financiarë nuk është i plotë vetëm në Bashkinë e Tiranës dhe Shkodrës. Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik është treguesi më problematik. Në këtë nënfushë ai mungon në 3/10 bashki dhe është i paplotë në një prej tyre.

Situata nuk është pozitive në **nënfushën e gjashtë “Zbatimi i buxhetit”**, pasi në 4 bashki mungon raporti mujor për ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa në 2 bashki informacioni nuk është i plotë.

**Në nënfushën e shtatë “Monitorimi, mbikëqyrja dhe auditimi i buxhetit”**, Bashkia e Korçës është e vetmja që ka arritur numrin më të lartë të pikëve të vlerësuara, ndërsa bashkitë e tjera kanë performuar dobët. Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë të plota vetëm në 3 bashki. Raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit dhe informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve) janë të plotë vetëm në 4/10 bashki. Ndërsa, regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik edhe pse mungon në 3/10 bashki (Kukës, Tiranë, Elbasan) është për t'u vlerësuar që është i plotë në gjysmën prej tyre 5/10.

**Në nënfushën e tetë “Vështirësitë financiare”**, vihet re që gjysma e bashkive nuk kanë publikuar një plan për daljen nga gjendja e vështirë financiare, pavarësisht faktit që gjatë 2019-2020 vendi ka kaluar dy situata të fatkeqësisë natyrore të lidhura me tërmetet e shtatorit dhe nëntorit 2019 dhe pandeminë Covid-19. Të dy këto ngjarje të jashtëzakonshme kanë goditur në mënyrë të ndjeshme ekonominë dhe në këto kushte pasja e një plani dhe strategjie për të përballuar pasojat e tyre duhet të kishte prioritet. Vetëm bashkitë e Fierit, Shkodrës dhe Korçës e kanë pasur të plotë këtë tregues.

**Nënfusha e nëntë “Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe asetëve”** paraqitet në nivel të ulët zbatimi, pasi vetëm 2/10 bashki (Fier, Shkodër) kanë publikuar informacion të plotë për asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose dhënie me qira dhe vetëm 4/10 bashki kanë publikuar kriteret ligjore që duhet të plotësohen.

Nënfusha e dhjetë “Donacionet” është në nivel jo të kënaqshëm, pasi vetëm gjysma e bashkive kanë publikuar emrat e donatorëve dhe vetëm 4/10 kanë publikuar shumat e donacioneve dhe qëllimin e tyre. Janë për t'u vlerësuar bashkitë Dibër, Lezhë dhe Shkodër, të cilat e kanë të publikuar të plotë informacionin për donacionet duke shënuar maksimumin e pikëve në këtë nënfushë.

## » Fusha III - Kërkesat për informim

**Fusha e tretë “Kërkesat për informim”** ka 8 nënfusha me 23 tregues. Informacioni i vënë në dispozicion në këtë fushë ka karakter kryesisht praktik dhe orientues dhe ka për qëllim t’i paraqesë qytetarit informacionin për procedurën e dërgimit të një kërkesë për informacion, duke filluar nga kontakti i koordinatorit për të drejtën e informimit e duke vijuar me formatin e kërkesës, afatet, procedurën e ankimit, tarifat etj. Në këtë fushë, një tregues shumë i rëndësishëm është regjistri i kërkesave dhe ankesave si dhe informacioni i kërkuar shpesh nga qytetarët nëpërmjet kërkesave për informim. Publikimi i tyre mundëson që kushdo që kërkon të njëjtin informacion të mund ta gjejë lehtësisht pa pasur nevojë të bëjë kërkesë.


Fusha e kërkesave për informim është një nga fushat ku bashkitë janë vlerësuar më pozitivisht dhe në përgjithësi informacioni (kryesisht teorik) për procedurën e kërkimit të informacionit është vënë në dispozicion. Përgjithësisht, informacioni i kësaj fushe është i plotë (duke përfshirë të gjitha dokumentet e nevojshme), i kuptueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm. Është konstatuar se ka bashki që nuk kanë publikuar adresën postare/elektronike, formatin e kërkesës për informim, apo ky format nuk është i aksesueshëm duke i vështirësuar qytetarit kërkesën për informim. Për t’u vlerësuar në këtë fushë në lidhje me përmbajtjen e informacionit janë bashkitë Durrës dhe Shkodër, të cilat kanë arritur maksimumin e pikëve. Me numrin më të ulët të pikëve është vlerësuar Bashkia Kukës, ndërsa bashkitë e tjera janë në një nivel të ngjashëm pikësh.

Niveli mesatar i transparencës për 10 bashkitë e monitoruara është 76.96%, ose transparencë pjesërisht e lartë. Kjo është fusha më transparente për bashkitë e monitoruara.

**Në nënfushën e parë “Të dhënat e koordinatorit për informim”**, performanca e përgjithshme e bashkive është shumë e mirë dhe 8/10 kanë shënuar maksimumin e pikëve. Problematike është Bashkia e Kukësit, të cilës i mungon informacioni në të gjithë treguesit, ndërsa Bashkia Lezhë nuk e ka të plotë informacionin për treguesin “detyrat dhe kompetencat e koordinatorit”.

**Nënfusha e dytë “Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim”** paraqet rëndësi të veçantë në praktikë sepse mundëson që publiku të qartësohet për veprimet dhe procedurat që duhet të ndjekë për të hartuar një kërkesë për informim apo një ankesë, afatet përkatëse, formatit të kërkesës të cilit mund t’i referohet si shembull etj. Është pozitiv fakti që gjysma e bashkive kanë shënuar maksimumin e pikëve në këtë nënfushë. Procedura që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion dhe afatet e marrjes së përgjigjes janë paraqitur të plota në 9/10 bashki, përveç asaj të Kukësit. Adresa postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim është e plotë në 7/10 bashki. Modeli

FIGURA 5  
FUSHA III - KËRKESAT  
PËR INFORMIME



standard i një kërkesë për informim është i plotë në 8/10 bashki, por mungon në atë të Kukësit dhe Dibërës. Informacioni për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim për mosdhënie informacioni mungon ose është i paplotë në 4 bashki (Kukës, Dibër, Tiranë, Elbasan) dhe adresa postare/elektronike për dërgimin e ankimit për mosdhënie informacioni mungon në 2 bashki, Kukës dhe Elbasan.

**Në nënfushën e tretë “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve”** 4/10 bashki kanë shënuar maksimumin e pikëve, Shkodra, Lezha, Durrësi dhe Fieri. Megjithatë një problematikë që vihet re është pasja e rubrikës së regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve thjesht si tekst, por mungesa e informacionit të aksesueshëm kur klikohet mbi të. Informacioni për të gjitha kërkesat për informim është i pjesshëm në 4/10 bashki, ndërsa informacioni i dhënë në përgjigje të tyre është i plotë në gjysmën e bashkive dhe tek të tjerat ka mangësi. Është pozitive që treguesi i përditësimit çdo 3 muaj i regjistrimit është plotësuar nga 6/10 bashki, ndërsa 3/10 nuk e kanë të plotë përditësimin, dhe në Bashkinë e Tiranës mungon.

**Nënfusha e katërt “Informacioni i dhënë më parë”** shfaqet më problematike dhe gjysma e bashkive kanë paraqitur mangësi. Konstatim i njëjtë është edhe për **nënfushën e tetë atë të informacioneve dhe dokumenteve që kërkohen shpesh**, e cila është e paplotë/mungon në gjysmën e bashkive. Përditësimi i këtyre treguesve, si regjistri, informacioni i kërkuar më parë dhe ai i kërkuar shpesh dhe paraqitja e tyre në një formë lehtësisht të përdorshme, do të lehtësonte edhe punën e vetë bashkive, pasi qytetarët dhe grupet e interesit do të investoheshin më pak në përdorimin e instrumentit të kërkesës për informacion, sepse mund t’u ndodhë që informacionin që u nevojitet ta gjejnë lehtësisht tek këto rubrika. Megjithatë është për t’u vlerësuar që informacioni i kërkuar shpesh është i plotë dhe aksesueshëm në bashki si ajo e Vlorës, Tiranës, Elbasanit, Shkodrës dhe Durrësit.

**Në nënfushën e pestë “Trajtimi i kërkesave për informacion”**, 6/10 bashki kanë shënuar pikët maksimale, ndërkohë që bashkitë e Lezhës, Tiranës dhe Kukësit nuk kanë plotësuar asnjë tregues. Në këto bashki mungon informacioni për procedurën e regjistrimit të kërkesës në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, afatet e trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë dhe mënyrën e dhënies së informacionit, ndërsa Bashkia e Elbasanit ka informacion të pjesshëm në të gjithë treguesit.

**Në nënfushën e gjashtë “Kufizimi i së drejtës për informim”**, e cila përfshin informacionin mbi rastet e kufizimit të së drejtës për informim (përcaktime të ligjit për të drejtën për informim) bashkitë e Kukësit dhe Lezhës nuk e kanë të plotësuar këtë tregues, ndërsa bashkitë e tjera kanë publikuar informacion të plotë

Sa i përket **nënfushës së shtatë “Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka”**, ajo është e plotë në 6/10 bashki, ndërsa bashkitë që kanë disa mangësi janë Kukësi, Dibra, Tirana dhe Vlora. Informacioni i plotë dhe i qartë për tarifat e vendosura për dhënien e informacionit mund të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të kërkesave për

informacion (p.sh., në rrugë elektronike, që nuk kanë kosto), pasi qytetarët duke mos pasur dijeni për tarifën mund të hezitojnë të kërkojnë informacionin.

## » **Fusha IV - Shërbimet që ofron bashkia**

**Fusha IV “Shërbimet që ofron bashkia”** ka tre nënfusha me 15 tregues. Fusha e shërbimeve të bashkisë është ndër më të rëndësishmet për qytetarët, sepse, ndryshe nga thuajse çdo fushë tjetër, është më e prekshme për ta, pasi ndikon në aspekte të përditshmërisë si transporti, furnizimi me ujë, arsimit, pastrimi i qytetit, shërbimet sociale, dokumente/vërtetime të ndryshme që lëshohen nga bashkia etj. Informacioni në këtë fushë ka për qëllim t’i vendosë publikut në dispozicion të dhëna për shërbimet publike dhe administrative që ofron bashkia, procedurat dhe kriteret e përfitimit, tarifën e tyre nëse ka të tilla, kriteret për t’u përjashtuar nga tarifën, strukturat tek të cilat duhet të drejtohen për t’i kërkuar këto shërbime apo për t’u ankuar, etj. Informacioni në lidhje me procedurën e ankimimit apo vërejtjes në lidhje me shërbimet është gjithashtu më rëndësi, sepse nxit llogaridhënien dhe përmirësimin e shërbimeve.

Pavarësisht rëndësisë së madhe që paraqet fusha e shërbimeve për qytetarët, shumica e bashkive kanë performuar pjesërisht dobët - Bashkia Vlorë nuk ka marrë asnjë pikë, ndërsa bashkitë Kukës dhe Elbasan kanë shënuar një numër shumë të ulët pikësh. Në këtë fushë ka performuar më mirë Bashkia Durrës, pasuar nga ajo e Dibërës dhe Korçës.


Niveli mesatar i transparencës për të 10 bashkitë e monitoruara është 53.3%, ose transparencë mesatare. Kjo është fusha e pestë më transparente për bashkitë e monitoruara.

Në nënfushën e parë “Shërbimet publike sipas 7 fushave të funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi”, Bashkitë Shkodër dhe Korçë kanë shënuar pikët maksimale dhe janë të vetmet që kanë publikuar informacion të plotë për të gjithë treguesit. Gjithashtu, këto bashki e kanë organizuar/grupuar informacionin në disa fusha, me qëllim lehtësimin e aksesit të përdoruesve. Informacioni i ofruar është i shkruar qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë. Ai është lehtësisht i përdorshëm, pasi mund të shkarkohet dhe printohet. Në të gjithë bashkitë e tjera, informacioni i kësaj fushe mungon ose është i paplotë.

Sa i përket **nënfushës së dytë “Shërbimet administrative sipas 7 fushave të funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi”**, informacioni është i plotë vetëm në Bashkinë e Durrësit. Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit janë publikuar në mënyrë të plotë në 8/10 bashki. Adresa postare/electronike e strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative mungon plotësisht



FIGURA 6  
FUSHA IV - SHËRBIMET  
QË OFRON BASHKIA



në gjysmën e bashkive. Një ndër informacionet më të rëndësishme, ai i procedurave që duhen ndjekur për të përfituar shërbimet administrative, është i plotë vetëm në gjysmën e bashkive. Ky informacion jo vetëm duhet publikuar i plotë, por duhet inkurajuar paraqitja në mënyrë sa më të qartë dhe të kuptueshme e dokumentacionit të kërkuar për të përfituar nga shërbimet, si p.sh., programet sociale të strehimit. Oraret e punës së strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative janë të publikuar në mënyrë të plotë vetëm në 3 bashki. Informacioni për tarifën për shërbimet administrative mungon plotësisht në 4 bashki dhe është i paplotë në 2 prej tyre. Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës janë publikuar në mënyrë të plotë në bashkitë Shkodër, Dibër, Korçë dhe Durrës. Nga ana tjetër, informacioni për subjektet që përjashtohen nga tarifën mungon ose është i paplotë në 8/10 bashki. Ky problem është identifikuar edhe në bashki me nivel të lartë transparence, si Korça dhe Shkodra. Ndërkohë që ka bashki, si p.sh., Fieri, që këtë informacion e kanë të publikuar jashtë Programit të Transparencës, në faqen e buxhetit, duke e bërë kështu më të vështirë gjetjen e tij. Subjektet e përjashtuara nga tarifën shpesh u përkasin grupeve të marginalizuara, të cilat kanë përgjithësisht akses të kufizuar në informacion dhe kjo situatë nuk u lehtësohet aspak nga mangësi të tilla në Programin e Transparencës së bashkive. Së fundmi, sa i përket organizimit të informacionit, ai është strukturuar në fusha sipas funksioneve të përcaktuara në ligj në gjysmën e bashkive të monitoruara.

### **Në nënfushën e tretë “E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet”,**

8/10 bashki kanë vënë në dispozicion informacion të plotë për procedurat për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet dhe adresën postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve. Përjashtim përbëjnë vetëm bashkitë Kukës dhe Vlorë. Ky lloj informacioni ndikon në përmirësimin e standardit të ofrimit të shërbimeve publike në tërësi, pasi u mundëson qytetarëve mbikëqyrje dhe monitorim për shërbimet që prekin drejtpërsëdrejti cilësinë e jetës së tyre. Nga ana tjetër, një informacion i tillë ndihmon bashkinë për të hartuar një sistem administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde, çka rrit më tej performancën dhe imazhin e institucionit tek qytetarët.

Në pamje të parë fakti që këto tregues janë plotësuar në nivel të lartë është pozitive, por në mënyrë që e drejta e ankimit të ushtrohet, është e nevojshme që në rradhë të parë qytetarët të kenë mundësi të informohen për shërbimet, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të administratës, lehtësimet dhe kriteret e përfitimit të tyre etj. Nëse kjo mungon, plotësimi i Programit të Transparencës vetëm në lidhje me procedurën e ankimit, nuk i shërben dot siç duhet publikut. Për shembull, në rastin Dibrës, që është një nga bashkitë me numrin më të lartë të pikëve në këtë fushë, informacioni për procedurën e ankesës është i plotë, por mungojnë adresat postare/elektronike të strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative. Pra, qytetari mund të dërgojë ankesë për shërbimin, por i mungon mundësia që t'i drejtohet drejtpërsëdrejti strukturës përgjegjëse për këtë shërbim. Është e rëndësishme që bashkitë të përmirësojnë/plotësojnë informacionin e kërkuar në nënfusha të tjera, në mënyrë që qytetarët duke patur informacion të plotë, të mund ta ushtrojnë

efektivisht të drejtën e ankimit. Praktikë pozitive e ndjekur nga disa bashki në fushën e shërbimeve është ajo e paraqitjes të shërbimeve në kategori/nënkategori të ndryshme si p.sh mjedisi, investimet, arsim-kulturë-sport, transport publik, lëvizje demografike etj., duke lehtësuar kështu gjetjen e informacionit.


## » *Fusha V - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore*

**Fusha V “Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore”** ka 1 nënfushë me 6 tregues. Në këtë fushë të Programit të Transparencës, bashkitë duhet të paraqesin kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore në bazë dhe në zbatim të të cilave funksionon dhe vepron qeverisja vendore, dokumentet politike vendore, vendimet e organeve të bashkisë, urdhëresa, urdhra etj. Fusha e legjislacionit dhe akteve të brendshme rregullatore në praktikë nuk paraqet ndonjë vështirësi për t’u plotësuar nga bashkitë, pasi konsiston në paraqitjen/publikimin e legjislacionit ekzistues dhe kuadrit rregullator, të cilët janë kryesisht materiale të gatshme që nuk kërkojnë ndonjë angazhim të mëtejshëm përveç publikimit. Pavarësisht kësaj, shumica e bashkive kanë performuar në nivel jo të kënaqshëm në këtë fushë. Dy bashki, Shkodra dhe Elbasani, janë vlerësuar me numrin maksimal të pikëve, ndërkohë që Bashkia e Kukësit nuk ka plotësuar asnjë tregues në këtë fushë dhe bashkitë e Lezhës dhe e Dibrës kanë arritur më pak se gjysmën e pikëve. Edhe bashki të tjera si, Bashkia e Korçës, Durrësit dhe Vlorës, kanë arritur të plotësojnë vetëm gjysmën e pikëve.

Ajo që vihet re tek bashkitë në këtë fushë është që shpesh herë informacioni është i shpërndarë, i pa organizuar mirë, i gjetshëm pas shumë shfletimesh dhe i vendosur jashtë Programit të Transparencës (p.sh Bashkitë Fier dhe Korçë). Informacioni është i **organizuar sipas funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi** në 6/10 bashki. Ndërkohë në ndonjë rast, informacioni ka qenë shumë teknik, i gjatë, dhe i vështirë për t’u kuptuar. **Aktet ligjore dhe nënligjore të fushës** janë të paplota në gjysmën e bashkive, ndërsa **dokumentet politike kombëtare përkatëse** janë të plota vetëm në 4 bashki. Vihet re që në pjesën më të madhe të bashkive (8/10) mungojnë apo janë të paplota **vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë**, dhe ato të **Këshillit të Bashkisë**. Këto të fundit mungojnë/janë të paplota në gjysmën bashkive. Këto dokumente paraqesin rëndësi të veçantë për komunitetin lokal ndryshe nga legjislacioni i përgjithshëm kombëtar, i cili ndoshta mund të aksesohet edhe në burime të tjera. Së fundmi, informacioni për **dokumentet politike vendore** është paraqitur i plotë vetëm në bashkitë e Shkodrës, Dibrës, Elbasanit dhe Vlorës.

Niveli mesatar i transparencës për të 10 bashkitë e monitoruara është 55.8%, ose transparencë mesatare. Kjo është fusha e katërt më transparente për bashkitë e monitoruara, në të njëjtin nivel me fushën e shërbimeve.

FIGURA 7  
FUSHA V - LEGJISLACIONI DHE  
AKTET E BRENDSHME RREGULLATORE




## » **Fusha VI** - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

**Fusha VI “Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”** ka 9 nënfusha më 32 tregues. Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje është një tregues i rëndësishëm për nivelin e demokracisë vendore dhe transparencës. Informacioni i kësaj fushe në Programin e Transparencës ndihmon që qytetarët të njohin procedurat dhe mjetet e disponueshme për të ndikuar në vendimmarrjen e qeverisjes vendore, nëpërmjet të drejtës për konsultim publik, apo duke përdorur mekanizma si nisma qytetare për çështje të caktuara që janë në vendimmarrje në këshillin bashkiak. Informacioni në këtë fushë është me rëndësi të veçantë, sepse përfshin informacion sipas kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit, ashtu dhe të atij për konsultimin publik.

Pavarësisht rëndësisë së informacionit që ka kjo fushë, rezulton se bashkitë kanë performuar më dobët në këtë fushë në krahasim me të tjerat. Numrin më të madh të pikëve në këtë fushë e ka Bashkia Shkodër, ndërkohë që të gjithë bashkitë e tjera qëndrojnë në nivel mesatar dhe më poshtë. Edhe pse kjo fushë është me 32 tregues, bashkitë e Kukësit dhe Dibrës nuk kanë plotësuar asnjërin prej tyre. Për disa bashki kjo ka qenë fusha me numrin më të ulët të pikëve, duke përfunduar kështu shqetësimin e përgjithshëm për dobësitë në zbatimin e ligjit për konsultimin publik. Në këtë fushë është pozitive që treguesi i të dhënave të koordinitorit për njoftimin e konsultimit publik është në përgjithësi i plotë dhe një pjesë e mirë e bashkive kanë marrë pikët maksimale. Megjithatë duket sikur disa bashki kanë “investuar” më shumë në publikimin e kontakteve, si në rastin e koordinitorit, se sa në publikimin e informacionit cilësor. Për shembull, Bashkia Tiranë, edhe pse nuk kanë dhënë informacion për procedurat e ankimimit lidhur me procesin e këshillimit me publikun, është mjaftuar me vënien në dispozicion të adresës postare/elektronike të koordinitorit për depozitimin e këtyre ankimeve. Si në fusha të tjera, edhe këtu ka raste që informacioni është publikuar jashtë Programit të Transparencës (Fieri, Korça) ose vetëm në Facebook (Fieri). Për më tepër, në Bashkinë e Fierit disa informacione të kësaj fushe gjenden në faqen e buxhetit, gjë që merr më shumë kohë për kërkim. Nga ana tjetër, në Bashkinë e Lezhës janë konstatuar dokumente apo lidhje me informacion të hershëm në kohë (mbi 10 viteve më parë), ndërsa në Bashkinë Tiranë gjendej një kalendar për nismat vendimmarrëse i pa përditësuar që nga viti 2016.

Niveli mesatar i transparencës për 10 bashkitë e monitoruara është 32.03%, ose transparencë pjesërisht e ulët. Kjo është fusha me transparencën më të ulët për bashkitë e monitoruara.

FIGURA 8  
FUSHA VI - P JESËMARRJA QYTETARE  
NË VENDIMARRJE



**Në nënfushën e parë “Të dhënat e koordinatorit për njoftimin e konsultimin publik”,** emri dhe mbiemri i koordinatorit dhe adresa e tij postare/elektronike janë publikuar të plotë në pjesën më të madhe të bashkive (7/10), ndërsa orari i tij i punës mungon në 4 bashki. Është pozitive që në këtë fushë, më shumë se gjysma e bashkive i kanë plotësuar siç duhet të gjithë treguesit.

**Nënfusha e dytë “Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje”**

paraqitet shumë problematike. Bashkia Shkodër është e vetmja që i ka plotësuar të gjithë treguesit, ndërsa në 6 bashki mungon plotësisht informacioni për aktet që do të konsultohen, veprimet që do të ndërmerren, afatet, dhe strukturat përgjegjëse, dhe në 3 prej tyre ky informacion është i pjesshëm. Ky informacion ka rëndësi të veçantë sidomos për grupet e interesit dhe aktorët që monitorojnë vendimmarrjen e organeve të bashkisë dhe synojnë të përfshihen në konsultime, të dorëzojnë rekomandime me shkrim etj. Publikimi i rregullt i planit vjetor u jep atyre mundësi të përgatiten dhe të planifikojnë punën e tyre monitoruese.

Edhe plotësimi i **nënfushës së tretë “Dispozitat e brendshme rregullatore për këshillimin me publikun”** është në nivel shqetësues. Ky informacion ka rëndësi për aspektin praktik të tij dhe synon të orientojë qytetarët e interesuar për mënyrat se si mund të përfshihen në konsultime. Megjithatë vetëm bashkitë Korçë dhe Shkodër kanë informacion të plotë sa i përket procedurave, afateve, mënyrave të organizimit të konsultimeve dhe strukturave përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim. Të gjithë bashkitë e tjera kanë informacion të mangët ose të paplotë, ndërsa bashkitë Tiranë dhe Lezhë kanë të plotë vetëm një tregues.

**Në nënfushën e katërt “Akte për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik”,** edhe pse ajo që kërkohet është thjesht paraqitja e një liste të shkurtër me akte për të cilat konsultimi është i detyrueshëm, 6 bashki nuk kanë publikuar asnjë informacion dhe 2 prej tyre kanë informacion të pjesshëm. Vetëm bashkitë e Shkodrës dhe e Durrësit e kanë publikuar të plotë listën e akteve. Ky informacion është me interes, pasi bëhet fjalë për akte të rëndësishme si buxheti, taksat e tarifatat vendore, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të pronave të tretëve etj.

**Në nënfushën e pestë “Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje”,** bashkia e Shkodrës është sërish bashkia me numrin maksimal të pikëve. Projektaktet, relacionet shpjeguese dhe dokumentet shoqëruese si dhe informacioni për arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektakteve dhe ndikimin që ato do të kenë, mungojnë plotësisht në pjesën më të madhe të bashkive. Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara dërgojnë rekomandimet e tyre janë paraqitur plotësisht nga Bashkia e Shkodrës, pjesërisht nga ajo e Elbasanit dhe Korçës, dhe janë në mungesë në bashkitë e tjera. Adresa e kontaktit e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik ose e strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve për projektaktin është e plotë vetëm në 3 bashki. Vendi dhe data e organizimit të takimit publik mungon plotësisht si informacion në 7/10 bashki. Mangësitë në këto informacione kufizojnë mundësitë e qytetarëve dhe grupeve të

interesit për t'u njohur me relacionet shpjeguese, me ndikimin e projektakteve që po miratohen dhe arsyet për nxjerrjen e tyre, për të marrë pjesë në takimet publike, si dhe për të dërguar komente dhe rekomandime për projektaktet që do të miratohen.

**Në nënfushën e gjashtë “Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve”** është për t'u vlerësuar Bashkia e Durrësit, e cila është e vetmja që ka arritur pikët maksimale, ndërsa bashkitë Kukës, Dibër, Tiranë dhe Elbasan nuk kanë shënuar asnjë pikë. Informacioni për adresën postare/elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve është i plotë në gjysmën e bashkive, ndërsa afati për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve është i plotë vetëm në 4 bashki. Ka mangësi në informacionin për mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit në takimet publike në 7/10 bashki. Sa i përket trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe grupet e interesit si edhe mënyrës së dhënies së arsyeve për mospranimin e tyre, ka mangësi informacioni në të gjitha bashkitë përveç asaj të Durrësit. Transparenca e informacionit në këtë fushë do të ndikonte në rritjen e besimit të qytetarëve tek procedura e shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve.

**Në nënfushën e shtatë “Procedurat e ankimit lidhur me procesin e këshillimit me publikun”** është për t'u vlerësuar Bashkia e Korçës, e cila është e vetmja që i ka plotësuar të gjithë treguesit. Informacioni për subjektet ku mund të bëhet ankim është i plotë në 6 bashki, ndërsa adresa postare/elektronike për dërgimin e ankimit është publikuar siç duhet vetëm në 4 bashki. Informacioni për procedurat për të bërë një ankim në lidhje me procesin e këshillimit me publikun mungon plotësisht në shumicën e bashkive, ndërsa informacioni për strukturën përgjegjëse që regjistron dhe shqyrton ankesën mungon në pjesën dërrmuese të bashkive dhe është i plotë vetëm në bashkitë e Tiranës dhe Korçës. Edhe në këtë nënfushë, transparenca ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve tek strukturat përgjegjëse nëpërmjet rritjes së llogaridhënies si dhe në qartësimin e tyre në lidhje me procedurën e ankimit.

**Në nënfushën e tetë “Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes”**, Bashkia e Durrësit është e vetmja që i ka plotësuar të gjithë treguesit. Kjo nënfushë është në nivel shqetësues, pasi gjysma e bashkive nuk kanë shënuar asnjë pikë, pra nuk kanë plotësuar asnjë tregues. Numri i akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti mungon dhe numri i përgjithshëm i komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara mungon në pjesën dërrmuese të bashkive. Numri i rekomandimeve e komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes është i plotë vetëm në Bashkinë e Durrësit, i pjesshëm në atë të Fierit, dhe mungon në të gjithë të tjerat. Ndërsa numri i takimeve publike të organizuara është publikuar në mënyrë të plotë nga Bashkia e Shkodrës dhe e Durrësit dhe në mënyrë të pjesshme nga ajo e Fierit dhe e Korçës. Informacioni i kësaj fushe, nëse publikohet siç duhet, përbën një tregues të rëndësishëm për transparencën e procesit vendimmarrës të bashkive përkatëse gjatë një viti të caktuar. Publikimi i rregullt i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes si dhe i planit vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje bën të mundur që grupet e interesit apo aktorë të ndryshëm të vlerësojnë realizimin e planit nga ana e bashkive.



Edhe plotësimi i **nënfushës së nëntë “Nisma qytetare”** është në nivel shqetësues, pasi gjysma e bashkive nuk kanë plotësuar asnjë tregues. Asnjë nga bashkitë nuk ka marrë numrin maksimal të pikëve, pra të gjitha kanë pasur mangësi. Mënyra dhe forma e paraqitjes së nismës qytetare janë publikuar në mënyrë të plotë vetëm nga 2 bashki, ajo e Shkodrës dhe e Vlorës. Procedura e shqyrtimit dhe e miratimit të nismës qytetare nuk është paraqitur e plotë në asnjë bashki, ndërsa ka informacion të pjesshëm në vetëm 3 prej tyre. Adresa postare/elektronike për depozitimin e nismës qytetare dhe mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mosmiratimin e nismës qytetare janë publikuar të plota vetëm në Bashkinë e Fierit. Instrumenti i nismës qytetare është i rëndësishëm, sepse u mundëson banorëve të një bashkie të paraqesin çështje me rëndësi për ta për vendimmarrje në këshillin bashkiak. Mungesa e informacionit për këtë instrument shoqërohet me mospërdorimin e tij nga ana e qytetarëve dhe kjo cenon demokracinë pjesëmarrëse.

## » **Fusha VII** - *Informacion tjetër*

**Fusha VII “Informacion tjetër”** ka 4 nënfusha me 10 tregues. Kategoria e “informacionit tjetër” është me interes sa i përket veprimtarive të bashkisë në lidhje me integrimin evropian si dhe veprimtarive dhe shërbimeve të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile në territorin e bashkisë. Nga ana tjetër, kjo fushë përmban informacion për strukturat komunitare, të cilat synojnë fuqizimin, organizimin dhe mobilizimin e qytetarëve për çështje që kanë rëndësi themelore për ta dhe janë faktor i rëndësishëm për aplikimin e demokracisë pjesëmarrëse. Së fundmi, në këtë fushë, bashkitë duhet të publikojnë studime, raporte, dhe vlerësime për zbatimin e transparencës. Ky tregues është me interes, sepse plotësimi ose mosplotësimi i tij tregon deri diku nëse bashkitë janë të hapura ose jo ndaj kritikës dhe rekomandimeve për përmirësim të bëra nga aktorë monitorues si organizatat e shoqërisë civile.


Në fushën e informacionit tjetër, bashkitë në përgjithësi janë nën nivelin mesatar të pikëve. Bashkitë që kanë performuar më mirë në këtë fushë janë Shkodra dhe Vlora. Ndërsa bashkitë që kanë shënuar një numër minimal pikësh janë Korça, Kukësi, Tirana, Durrësi, Elbasani.

Niveli mesatar i transparencës për të 10 bashkitë e monitoruara është 38%, ose transparencë pjesërisht e ulët. Kjo është fusha e parafundit, ose e gjashta në renditje për nga niveli i transparencës për bashkitë e monitoruara.

**Në nënfushën e parë “Bashkia në proceset e integritit evropian”** është pozitive që shumica e bashkive kanë publikuar të dhëna të plota për projektet, nismat dhe veprimtaritë e bashkisë në kuadrin e integritit në Bashkimin Evropian. Në vështrim krahasues me nënfushat e tjera vihet re që kjo është nënfusha të cilës të gjitha bashkitë i kanë kushtuar më shumë rëndësi. Madje, ka bashki që edhe pse kanë zero pikë tek të gjithë nënfushat e tjera, tek nënfusha e integritit në Bashkimin Evropian kanë pikët maksimale, p.sh Bashkia e Tiranës.

FIGURA 9

FUSHA VII - INFORMACION TJETËR



**Në nënfushën e dytë “Bashkia dhe shoqëria civile”** asnjëra nga bashkitë nuk e ka publikuar informacionin e plotë ndërsa bashkitë Durrës, Kukës, Tiranë, Korçë nuk kanë plotësuar asnjë nga treguesit. Bashkia e Tiranës shënon zero pikë në këtë nënfushë edhe pse është bashkia me numrin më të madh të organizatave aktive dhe qyteti ku kanë përqendruar aktivitetin pjesa dërrmuese e tyre. Në tërësi, të dhëna për grupet e interesit janë të publikuar në mënyrë të plotë vetëm në Bashkinë e Shkodrës, në mënyrë të pjesshme në 3 bashki dhe mungojnë në të gjitha të tjerat. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit janë të plota vetëm në 2 bashki. Të dhënat për shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme janë të plota vetëm në 3 bashki dhe mungojnë plotësisht tek të tjerat. Organizatat e shoqërisë civile shpeshherë ofrojnë shërbime pa pagesë që i mungojnë gamës së shërbimeve publike apo i plotësojnë ato. Ndaj, publikimi i këtij informacioni do të ishte shumë i dobishëm për publikun. Nga ana tjetër, informacioni mbi nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile nuk është i plotë në asnjë bashki, ndërsa mungon plotësisht në 8/10 bashki. Pasja e informacionit për veprimtarinë e organizatave të shoqërisë civile dhe promovimi i tyre dëshmojnë ndër të tjera për një institucion të hapur dhe bashkëpunues, që i vlerëson grupet e interesit dhe që i konsideron ata si partnerë.

**Në nënfushën e tretë “Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Transparencës”** është për t’u vlerësuar fakti që 5 bashki kanë publikuar raporte, studime dhe vlerësime që janë bërë në lidhje me zbatimin e transparencës së tyre, madje një pjesë e mirë kanë shënuar maksimumin e pikëve në këtë nënfushë. Megjithatë kjo nënfushë nuk ka marrë asnjë pikë në Bashkinë e Tiranës, e cila është bashkia më e madhe në vend dhe ka vëmendjen më të madhe të aktorëve monitorues. Raportet dhe vlerësimet e publikuara nga organizata të shoqërisë civile mbi transparencën e kësaj bashkie nuk mungojnë. Kjo nënfushë është me rëndësi, sepse tregon ndër të tjera se sa të hapura janë bashkitë për të pranuar kritikën e, për rrjedhojë, edhe prirjen e tyre për vetë-përmirësim.

**Në nënfushën e katërt “Strukturat komunitare”**, të dhënat për strukturat komunitare në fshat dhe në qytet mungojnë në pjesën më të madhe të bashkive. Ky informacion është i rëndësishëm për të nxitur organizimin komunitar dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Informacioni mbi detyrat dhe kompetencat e këtyre strukturave është publikuar i plotë në gjysmën e bashkive ndërsa, rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare është e publikuar vetëm në bashkitë e Fierit dhe të Vlorës. Ky tregues është shfaqur problematik dhe mungon edhe në Bashkinë e Shkodrës, e cila nuk ka publikuar një rregullore për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare.

Së fundmi, është vënë re që në një pjesë të bashkive kjo fushë mungonte plotësisht në Programin e Transparencës dhe pjesë të saj gjendeshin të shpërndara në rubrika të tjera, gjë që e vështirëson marrjen e informacionit të kërkuar nga publiku.

## 6. Përfundime

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime thelbësore për demokracinë vendore. Informacioni publik dhe i aksesueshëm për veprimtarinë e institucioneve të vetëqeverisjes vendore mundëson monitorimin e vendimmarrjes, pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces, duke sjellë si rezultat rritjen e besimit të publikut në qeverisjen vendore. Ndërkaq, llogaridhënia publike siguron që zyrtarët vendorë të përgjigjen në mënyrë të hapur dhe të mbajnë përgjegjësi për vendimet që marrin në emër të qytetarëve.<sup>44</sup>

Pavarësisht progresit të bërë deri tani, procesi i monitorimit të transparencës i kryer në 12 bashkitë e vendit tregon se ka akoma nevojë për punë që Programi i Transparencës të jetë funksional dhe i plotësuar me informacion. Edhe pse 10/12 bashki janë të pajisura me Programin e Transparencës dhe të gjitha kanë faqe uebi, nëse këto nuk janë të plotësuara me informacione, nuk mund t'i shërbejnë në mënyrë efektive publikut.

Nga monitorimi konstatohet që përgjithësisht bashkitë kanë publikuar në mënyrë të plotë si në formë ashtu edhe në përmbajtje ato kategori informacioni që konsiderohen më “të lehta” dhe informative për publikun. Për rrjedhojë, fushat ku informacioni është përgjithësisht teorik dhe jo sensitiv janë edhe fushat ku bashkitë kanë performuar më mirë në krahasim me të tjerat, si p.sh ajo e **informacionit në lidhje me kërkesat për informim** që është fusha me transparencën më të lartë (76.96%, transparencë pjesërisht e lartë) si dhe fusha e informacionit mbi **organizimin dhe funksionimin e bashkisë** (64.06%, transparencë pjesërisht e lartë, renditur e treta). Megjithëse me transparencë pjesërisht të lartë, fusha e organizimit dhe funksionimit paraqiste mangësi në disa tregues, si kalendari dhe njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo rendi i ditës. Ndërsa në fushën e kërkesave për informim, treguesit më problematikë ishin ata të informacionit të kërkuar më parë dhe atij të kërkuar më shpesh. Struktura organizative dhe numri i punonjësve si dhe të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit janë ndër treguesit me performancën më pozitive në këto dy fusha.

**Fusha e transparencës ekonomiko-financiare**, pavarësisht mangësive, është fusha e dytë me performancën më të mirë, me transparencë mesatare 65%, e cila klasifikohet

....

44 IDM (2018a). Udhëzues Praktik: Bashkitë për të drejtën e informimit në veprim. Tiranë 2018

si pjesërisht e lartë. Në këtë fushë është pozitiv fakti që buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin është publikuar në mënyrë të plotë në të gjithë bashkitë. Megjithatë, një pjesë e mirë e informacionit të kësaj fushe që konsiderohet me natyrë më sensitive, siç është ai i lidhur me monitorimin dhe auditimin e buxhetit, prokurimet publike, donacionet, informacioni për asetet dhe pronat e ofruara për shitje, ose dhënie me qira mungojnë për një pjesë të konsiderueshme të bashkive. Në këtë fushë, transparencën më të ulët e kanë bashkitë Vlorë dhe Kukës.


Pavarësisht se nga bashkitë është publikuar informacioni me natyrë teorike dhe jo sensitive në përgjithësi, kjo nuk vlen për **fushën e legjislacionit dhe akteve të brendshme rregullatore**, e cila edhe pse nuk paraqet natyrë sensitive apo vështirësi në publikimin e informacionit, ka pasur mangësi të mëdha në një pjesë të mirë të bashkive. Transparenca në këtë fushë është e kategorisë mesatare, 55.83%. Në këtë fushë, problematikë ishin sidomos treguesit e dokumenteve politike vendore dhe vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ. Për t'u vlerësuar janë bashkia Shkodër dhe Elbasan që kanë arritur pikët maksimale, ndërkohë që në PT e Bashkisë Kukës fusha e legjislacionit mungonte plotësisht.

Në nivel mesatar transparence është gjithashtu edhe **fusha e shërbimeve** (53.33%). Në këtë fushë është për t'u vlerësuar Bashkia Durrës, e cila ka arritur pikët maksimale, ndërsa në PT e Bashkisë Vlorë kjo fushë mungon plotësisht. Është pozitive që treguesi i procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet është publikuar siç duhet në pjesën dërrmuese të bashkive, ndërkohë që problematik paraqitet informacioni për subjektet që përjashtohen nga tarifat dhe oraret e punës së strukturave/njësive/sporteleva që ofrojnë shërbime administrative.

Kategoria e **informacionit tjetër** kategorizohet me transparencë pjesërisht të ulët (38%). Në këtë fushë, informacioni në lidhje veprimtarinë e shoqërisë civile dhe strukturat komunitare është publikuar në nivel të ulët. Kjo mund të shërbejë edhe si tregues për nivelin e bashkëpunimit apo promovimit të veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në nivel vendor. Në këto fusha ka bashki me numër minimal pikësh (Kukës, Tiranë, Durrës, Elbasan) si dhe bashki që nuk kanë plotësuar asnjë tregues (Korça).

Fusha ku bashkitë janë treguar më pak transparente është ajo **pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje**, me transparencë pjesërisht të ulët, 32.03%. Kjo fushë mungon plotësisht në PT e dy bashkive, asaj të Kukësit dhe Dibrës. Në këtë fushë mungojnë të dhëna për nismat vendimmarrëse, procedurën e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve dhe raporti vjetor për transparencën e bashkisë. Ndër treguesit më të plotë në këtë fushë janë informacioni për koordinatorin për njoftimin e konsultimit publik si dhe për subjektet për ankimimin lidhur me procesin e këshillimit me publikun.

FIGURA 10  
RENDITJA E PERFORMANCËS  
MESATARE NË SECILËN FUSHË NË %  
NGA MË TRANSPARENTJA TEK MË PAK  
TRANSPARENTJA



Nga monitorimi u konstatua që informacione të dobishme, që bëhen publike pa kërkesë, janë të publikuara si nëntituj apo kategori të ndryshme brenda faqes zyrtare të internetit të bashkive, por jashtë kategorive të “Programit të Transparencës”. Kjo bën që kërkuesi të bëjë shumë shfletime, duke e vështirësuar kërkimin si dhe duke bërë që të shpenzohet më shumë kohë. Nëse informacioni do të paraqitej në përputhje me strukturën e modelit standard të Programit të Transparencës, qytetarët dhe aktorët e interesuar do të ishin të mirëinformuar. Megjithatë, është praktikë pozitive e disa bashkive publikimi i informacionit lehtësisht të përdorshëm, që mund të shkarkohet dhe printohet fare lehtë si dhe vendosja e një tablele me përmbajtje automatike që lehtëson kërkimin e informacionit në faqen e internetit.

Disa problematika të tjera të identifikuar në lidhje me aksesueshmërinë ishin publikimi i informacionit të vjetëruar dhe të papërditësuar, publikimi i materialeve voluminoze apo në gjuhë tepër teknike, si dhe publikimi i lidhjeve/rubrikave thjesht si tekst, por mungesa e informacionit të aksesueshëm kur klikohet mbi to, siç ishte rasti i regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve në disa bashki. Përveç kësaj, në pjesën dërrmuese të bashkive mungonte informacioni për rubrikën “informacioni i dhënë më parë” si dhe informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh, informacion ky që praktikisht do të lehtësonte punën e bashkisë si dhe procesin e kërkimit për qytetarët. Ishte pozitiv fakti që disa bashki kishin publikuar informacione të dobishme që lidhen me masat kundër COVID-19, përditësime në lidhje me situatën e pandemisë, informimit në distancë apo të mënyrave për të kërkuar ndihmën e shpejtë. Megjithatë, nga ana tjetër, pjesa dërrmuese e bashkive nuk kishin një plan për daljen nga situata e vështirë financiare, të ndikuara nga dy situatat e fatkeqësive natyrore gjatë viteve 2019-2020.

Për përmirësimin e situatës në lidhje me fushat që janë gjendur me mangësi informacioni, më poshtë jepen një sërë rekomandimesh për bashkitë, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe për organizatat e shoqërisë civile.

# 7. Rekomandime

## Për bashkitë

### Në lidhje me paraqitjen e PT-së:

- Të publikohet Programi i Transparencës si rubrikë e dukshme në menynë kryesore. Përmbajtja e tij të jetë në përputhje me strukturën e modelit standard të PT për pushtetin vendor të miratuar nga KDI. Të gjithë informacionet sipas fushave të jepen të plota në PT si dhe të jenë lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët.
- Informacioni duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm, duke lejuar shkarkimin apo printimin, si dhe të jetë i përshtatur për personat me nevoja te veçanta. Duhet të shmanget publikimi i dokumenteve voluminozë me gjuhë teknike dhe të hartohen përmbledhje të tyre në një gjuhë sa më të kuptueshme për publikun.

### Në lidhje me përmbajtjen e PT-së:

#### ***Fusha I: Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë***

- Të publikohen dhe të përditësohen dokumentet që lidhen me veprimtarinë vendimmarrëse të organeve të bashkisë, të cilat mundësojnë konsultimin dhe monitorimin nga ana e grupeve të interesit, si kalendari i mbledhjeve të këshillit bashkiak, njoftimet për mbledhje të këshillit bashkiak, rendi i ditës, projekt-vendimet në proces shqyrtimi, si dhe vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ të kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak.

#### ***Fusha II: Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare***

- Të publikohet në mënyrë koherente dhe të plotë dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm në të gjitha fazat e tij për të mundësuar monitorim dhe konsultim publik efikas.
- Të publikohet i plotë dhe të përditësohet rregullisht regjistri i parashikimeve të prokurimit publik, informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave si dhe asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose dhënie me qira.
- Të publikohet rregullisht raporti mujor për ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, raportet e monitorimit të zbatimit të



buxhetit, raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit si dhe informacioni i plotë për burimin, shumat dhe qëllimet e donacioneve.

- Të hartohet dhe të publikohet një plan i mirëfilltë në nivel vendor për daljen nga situata e vështirë financiare për t'iu përgjigjur pasojave negative ekonomike të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
- Të plotësohet me informacion lehtësisht të kuptueshëm rubrika e paketës fiskale dhe të reflektojë në mënyrë të plotë afatet e pagimit të taksave dhe tarifave, format e pagesës si dhe kamatëvonesat dhe penaltetet.

### ***Fusha III: Kërkesat për informim***

- Të publikohet i plotë regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit si dhe të përditësohet rregullisht çdo tremujor.
- Të plotësohen dhe të përditësohen rubrika e “informacionit të dhënë më parë” dhe “informacionit të kërkuar shpesh” për të lehtësuar procesin e kërkimit për qytetarët si dhe punën e vetë bashkive.

### ***Fusha IV: Shërbimet që ofron bashkia***

- Të publikohet në mënyrë të plotë dhe të qartë informacioni për procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbimet administrative, tarifat e shërbimeve, mënyrën e pagesës së tyre si dhe për subjektet që përjashtohen nga pagimi i këtyre tarifave.

### ***Fusha V: Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore***

- Të publikohet në mënyrë të plotë dhe të kuptueshme informacioni mbi të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për pushtetin vendor si dhe dokumentet e politikave kombëtare dhe vendore.

### ***Fusha VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje***

- Të hartohet dhe publikohet plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje duke përfshirë aktet që do të konsultohen, veprimet që do të ndërmerren, procedurat dhe afatet e konsultimeve dhe strukturat përgjegjëse. Gjithashtu, duhet të hartohet dhe publikohet në mënyrë të rregullt raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për të vlerësuar zbatimin e planit vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje.
- Të publikohet në mënyrë koherente dhe të plotë informacioni për nismat vendimmarrëse duke përfshirë projekt-aktet dhe relacionet e tyre shpjeguese, afatin, vendin dhe mënyrën e dërgimit dhe trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve, adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe

konsultimin publik, vendin dhe datën e organizimit të takimit publik, procedurën e ankimimit. Të publikohet informacion i plotë dhe i qartë në lidhje me nismën qytetare, mënyrën dhe formën e paraqitjes së saj, procedurën e shqyrtimit.

### **Fusha VII: Informacion tjetër**

- Të publikohen të dhëna në lidhje me grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile, veprimtaritë dhe shërbimet që ofrojnë ata si dhe raporte, studime dhe vlerësime për zbatimin e transparencës të kryera nga grupet e interesit.
- Të publikohen të dhëna për strukturat komunitare në fshat dhe në qytet, detyrat dhe kompetencat e këtyre strukturave si dhe rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare.

### **Për organet e bashkisë, këshillin bashkiak dhe kryetarin e bashkisë:**

- Të ushtrojnë vendimmarrjen e tyre në lidhje me miratimin e PT me informacionin e plotë për të gjitha fushat e saj (kërkesa të programit model të transparencës) duke marrë në konsideratë rekomandimet e mësipërme.
- Të luajnë një rol më aktiv në monitorimin e PT dhe të rrisin llogaridhënien nga ana e administratës në rastet kur cenohet e drejta e informimit.
- Të parashikojnë në rregulloret e brendshme të stafit apo në Kodin e Etikës masat ndëshkuese që merren në rast të mosparaqitjes në kohë të informacioneve në PT apo regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve.
- Të zgjerojnë gamën e informacioneve që publikohen në PT duke iu përgjigjur situatave, nevojave dhe kontekstit lokal. Lista e treguesve të detyrueshëm për t'u publikuar në PT nuk duhet të konsiderohet shteruese, por vetëm si një hap i parë dhe i domosdoshëm drejt llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.
- Të alokojnë burime për të kryer studime/vlerësime cilësore të nevojave të bashkive në lidhje me kapacitetet, sfidat dhe problematikat e bashkive për sa i përket transparencës proaktive.
- Të alokojnë burime për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit për të kryer monitorime më sistematike me qëllim përmirësimin e transparencës së veprimtarisë së tyre.

## Për Komisionerin për të Drejtën e Informimit:

- Të realizojë aktivitete periodike monitorimi për programet e transparencës në bashkitë e vendit brenda kompetencave monitoruese që i janë dhënë me ligj.
- Të hartojë një strategji institucionale të komunikimit me publikun, për bashkitë dhe aktorët e interesuar në kuadër të garantimit të së drejtës për informim në nivel vendor.
- Të ndërtojë sisteme me qasje sistematike për ndjekjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të nxjerra për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga KDI si edhe përgjigjen e bashkive ndaj rekomandimeve të dhëna në funksion të garantimit të së drejtës për informim të qytetarëve.
- Të përditësojë modelin e PT për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ta bërë të aksesueshëm për persona me aftësi të veçanta si dhe për të përfshirë në të përdorimin e mediave sociale.
- Të promovojë krijimin e një platforme dixhitale kombëtare që përmban programet e transparencës së 61 bashkive të vendit, që mundëson vlerësimin e transparencës së secilës bashki sipas fushave të ndryshme dhe krahasimin e të dhënave në mënyrë vizuale. Kjo do të ndihmonte në rritjen e ndërgjegjësimit për nivelin e transparencës të PT-ve në bashki të ndryshme.


## Për Organizatat e Shoqërisë Civile

- Të monitorojnë aktivisht transparencën në njësitë e qeverisjes vendore si vëzhgues i sjelljes së institucioneve publike për garantimin dhe respektimin e të drejtës së qytetarëve për t'u informuar.
- Të kryejnë aktivitete advokuese në promovimin dhe ndërgjegjësimin publik rreth ligjit dhe mënyrën se si qytetarët duhet të ushtrajnë këtë të drejtë.
- Të jenë aktivë në trajtimin e shkeljeve për të drejtën për informim dhe konsultim publik sipas hallkave të procedimit administrativ dhe gjyqësor.
- Të organizojnë aktivitete informuese për qytetarët për të bërë të mundur rritjen e ndërgjegjësimit për ekzistencën dhe mënyrën e funksionimit të instrumenteve të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, të tilla si buxhetimi me pjesëmarrje, nisma qytetare, strukturat komunitare në fshat dhe qytet, etj.

# 8. Shtojcat

## Shtojca 1. Bashkitë pa Program Transparence

FIGURA 11  
BASHKITË PA PROGRAM TRANSPARENCE



	Gjirokastër	Berat
1. Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë	25%	86%
2. Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare	7%	84%
3. Kërkesat për informim	28%	67%
4. Shërbimet që ofron bashkia	0%	50%
5. Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore	0%	50%
6. Pjesëmarrja qytetare në vendimarrje	13%	22%
7. Informacion tjetër	5%	0%

Gjatë procesit të monitorimit të kryer gjatë periudhës gusht-shtator 2020 në bashkitë që janë objekt i këtij raporti u identifikua që dy bashki, Bashkia e Beratit dhe ajo Gjirokastrës, nuk kishin Program Transparence. Në këto dy bashki janë monitoruar informacionet që kanë qenë të publikuara në faqet ueb gjatë periudhës së monitorimit. Për këtë arsye, niveli i transparencës dhe llogaridhënies së këtyre dy bashkive është analizuar veçmas në këtë pjesë.

Gjatë periudhës së monitorimit, në Bashkinë e Gjirokastrës, Programi i Transparencës mungonte plotësisht ndërsa në Bashkinë e Beratit gjendej si rubrikë, por kjo e fundit ishte bosh, e pa plotësuar me informacione. Pavarësisht kësaj mangësie të përbashkët, këto dy bashki kanë ndryshime të ndjeshme në nivelin e transparencës: Bashkia Gjirokastrë i përket kategorisë “transparencë e ulët” me nivel transparence 13.9%, ndërsa Bashkia Berat i përket kategorisë “transparencë mesatare” me nivel transparence 57%.

Fusha e parë “**Për organizimin dhe funksionimin e bashkisë**” është një nga fushat ku dy bashkitë kanë performuar më mirë se në të tjerat. Megjithatë, ato kanë ndryshime të ndjeshme mes tyre në nivelin e pikëve. Kjo është një nga fushat me performancën më të lartë për Bashkinë e Beratit, ndërsa Bashkia e Gjirokastrës ka një numër shumë më të ulët pikësh (edhe pse më i larti për këtë bashki në krahasim me fushat e tjera.) Për organizimin administrativ-territorial, misionin dhe funksionet, Bashkia Berat ka publikuar informacion të plotë, ndërsa në Bashkinë Gjirokastrë informacioni i kësaj nënfushe mungon plotësisht. Bashkia e Beratit e ka të plotë informacionin për organet e bashkisë në pjesën dërrmuese të treguesve përveç të dhënave për arsimin, kualifikimet dhe pagën e kryetarit dhe orarin e pritjes. Ndërsa në Bashkinë Gjirokastrë, gjendet i plotë informacioni vetëm për një tregues, atë të kalendarit, teksa mungon plotësisht informacioni për rregulloren, njoftimet për mbledhje, rendin e ditës, kryetarin e bashkisë dhe procedurat e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e tij, orarin e pritjes dhe adresën postare/elektronike. Informacionet e tjera të paraqitura janë të paplota. Sa i përket informacionit për administratën e bashkisë, të dy bashkitë kanë mangësi në strukturën e pagave dhe adresën postare dhe elektronike të zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive në varësi të saj. Në Bashkinë Berat këto informacione janë të paplota, ndërsa në Bashkinë Gjirokastrë mungojnë plotësisht. Bashkia Berat i ka të plotë pothuajse të gjithë treguesit e tjerë në lidhje me administratën e bashkisë, ndërsa Bashkisë Gjirokastrë i mungojnë plotësisht shumica e informacioneve. Në lidhje me procedurat e bërjes së kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve lidhur me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës, të dy bashkitë janë pothuajse në të njëjtin nivel, dhe nuk kanë publikuar informacion në nivel të kënaqshëm. Përgjithësisht informacioni i adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve, i cili mungon plotësisht në Bashkinë Berat, por është i pjesshëm në Bashkinë e Gjirokastrës.

Në fushën e dytë “**Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare**” diferencat ndërmjet dy bashkive janë shumë të mëdha. Edhe pse kjo fushë ka 29 tregues, bashkia Gjirokastrë ka shënuar vetëm 4 pikë gjithsej. Të vetmit tregues që ka plotësuar

kjo bashki janë informacionet që lidhen me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë. Ndërsa Bashkia Berat, edhe pse me performancë ndjeshëm më të mirë, ndryshe nga Bashkia Gjirokastrë, treguesit e planit të zhvillimit strategjik i ka të paplotë, ndërsa i mungon plotësisht informacioni për burimet e financimit. Një tjetër pikë problematike për Bashkinë Berat është mangësia e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit. Nga ana tjetër, të dy bashkive u mungon plotësisht plani për daljen nga situata e vështirë financiare. Së fundmi, është për t'u vlerësuar fakti që Bashkia Berat ka publikuar informacion të plotë për nënfushat të rëndësishme si programi buxhetor afatmesëm vendor, buxheti vjetor dhe zbatimi i buxhetit, shitja ose dhënia me qira e pronave dhe asetëve dhe donacionet, ndërkohë që në Bashkinë Gjirokastrë informacioni për këto nënfusha mungon plotësisht.

Fusha e tretë **“Kërkesat për informim”** është fusha ku Bashkia Gjirokastrë ka arritur nivelin më të lartë të pikëve në krahasim me fushat e tjera. Megjithatë diferenca me Bashkinë Berat është e madhe edhe në këtë fushë. Problematike për të dy bashkitë paraqiten mungesa e adresës postare/elektronike për dërgimin e ankimit për mosdhënie informacioni, mungesa e informacionit të dhënë më parë, mospërditësimi çdo tre muaj i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve shoqëruar me tarifat nëse ka, si dhe mungesa e informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim. Disa tregues të rëndësishëm ku Bashkia Berat nuk ka publikuar informacion dhe ka rezultuar më dobët se ajo e Gjirokastrës janë modeli standard i një kërkesë për informim dhe adresa postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim. Nga ana tjetër, duhet theksuar që Bashkia Gjirokastrë, në shumicën e rasteve, edhe kur ka publikuar informacion, ai ka qenë i pjesshëm. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është ndër nënfushat më problematike për Bashkinë Gjirokastrë, duke parë se nuk është publikuar asnjë nga treguesit.

Në fushën e katërt **“Shërbimet që ofron bashkia”** Bashkia Gjirokastrë nuk ka publikuar asnjë informacion, ndërsa Bashkia Berat ka plotësuar vetëm gjysmën e pikëve. Të dy bashkive u mungonin plotësisht informacione të rëndësishme si ato për procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbimet administrative, për të drejtën e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet, adresa postare/elektronike e strukturave/njësive/sporteve që ofrojnë shërbime administrative, tarifat për shërbimet administrative si dhe rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës. Ndërsa një pjesë e mirë e treguesve të tjerë, janë të plotësuar në bashkinë e Beratit.

Edhe në fushën e pestë **“Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore”** Bashkia Gjirokastrë nuk ka plotësuar asnjë informacion, ndërsa ajo e Beratit ka plotësuar vetëm gjysmën e pikëve. Vihet re që kjo e fundit ka publikuar në mënyrë të plotë aktet ligjore dhe nënligjore të fushës dhe dokumentet politike kombëtare përkatëse si dhe i ka organizuar sipas funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, por nuk ka publikuar dokumente shumë të rëndësishme në nivel vendor si vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë dhe dokumentet politike

vendore. Kërkimi i vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave të kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak paraqitet i vështirë, pasi nevojiten shumë shfletime në rubrikat e tjera të faqes zyrtare.

Në fushën e gjashtë **“Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”** të dy bashkitë kanë performuar dobët. Edhe pse kjo fushë ka 32 tregues, të dy bashkitë kanë plotësuar një numër të ulët pikësh, Berat 14/64, ndërsa Gjirokastra 8/64. Në disa nënfusha, si plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje, akte për të cilat është i detyrueshëm konsultimi publik, raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes dhe nisma qytetare, asnjëra nga bashkitë nuk ka pasur të plotësuar asnjë tregues. Është pozitive që një nënfushë e rëndësishme siç është ajo e të dhënave të koordinatorit për njoftimin e konsultimit publik është më e plotë nga të gjitha.

Edhe fusha e shtatë **“Informacion tjetër”** është shumë e dobët për të dy bashkitë, pasi bashkia Berat nuk ka plotësuar asnjë pikë, ndërsa ajo e Gjirokastrës 1/20 pikë. I vetmi tregues në këtë fushë ku Bashkia Gjirokastrë kishte publikuar informacion të pjesshëm ishte ai mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritetit në BE. Ndërsa të dhënat për organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit, veprimtaritë dhe shërbimet e tyre mungojnë plotësisht në të dy bashkitë. Ndërkohë që për Bashkinë Berat kjo është fusha me performancën më të dobët.

Së fundmi, mund të thuhet që Bashkia Gjirokastrë ka pasur në përgjithësi performancë të dobët. Megjithatë, dy fushat ku kjo bashki ka pasur më shumë informacion të publikuar janë ajo e organizimit dhe funksionimit të bashkisë dhe kërkesave për informacion. Ndërsa Bashkia Berat, e ka shënuar numrin më të lartë të pikëve në fushë e transparencës dhe llogaridhënies ekonomiko-financiare si dhe organizimit dhe funksionimit të bashkisë. Fushat me performancën më të dobët për Bashkinë e Beratit janë fusha e informacionit tjetër dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, ndërsa për Bashkinë e Gjirokastrës janë fusha e shërbimeve dhe legjislacionit, tek të cilat kjo bashki nuk ka plotësuar asnjë tregues.

Në përgjithësi, të dy bashkitë, edhe pse kanë diferencë të mëdha mes tyre, kanë mangësi në informacione shumë të rëndësishme për qytetarët si pjesëmarrja në vendimmarrje apo fusha e shërbimeve, dokumentet politike dhe normative vendore, të drejtën e ankesës etj. Mungesa e Programit të Transparencës dhe publikimi i informacioneve të shpërndara dhe me mangësi të rëndësishme janë në shkelje të Ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe u kufizon qytetarëve jo vetëm të drejtën e informimit, por edhe shumë të drejta të tjera që preken prej saj që lidhen me ushtrimin efektiv të ankimeve, shfrytëzimin e mekanizmave për t’u përfshirë në vendimmarrje, marrjen e shërbimeve publike dhe administrative, etj.

## Shtojca 2. Tabelë përmbledhëse: Niveli i transparencës së PT-së sipas bashkive

Fusha	Nr. i Pikëve	Shkodër	Elbasan	Dibër	Durrës	Fier	Korçë	Kukës	Lezhë	Tiranë	Vlorë
Fusha I - Për organizimin dhe funksionimin e bashkisë	64	78%	75%	77%	91%	78%	81%	8%	78%	55%	20%
Fusha II - Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare	58	91%	67%	83%	72%	78%	81%	33%	74%	47%	24%
Fusha III - Kërkesat për informim	46	100%	72%	72%	100%	96%	80%	9%	74%	76%	80%
Fusha IV - Shërbimet që ofron bashkia	30	80%	20%	93%	67%	63%	93%	13%	43%	60%	-
Fusha V - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore	12	100%	100%	33%	50%	75%	50%	-	33%	67%	50%
Fusha VI - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje	64	78%	14%	-	56%	56%	47%	-	25%	19%	25%
Fusha VII - Informacion tjetër	20	85%	20%	60%	15%	50%	-	5%	55%	10%	80%
<b>Totali i Fushave I + II + III+ IV + V + VI + VII</b>	<b>294</b>	<b>86%</b>	<b>52%</b>	<b>59%</b>	<b>75%</b>	<b>71%</b>	<b>70%</b>	<b>12%</b>	<b>58%</b>	<b>51%</b>	<b>35%</b>



### Shtojca 3. Fushat, nënfushat dhe treguesit e sistemi të matjes së transparencës dhe llogaridhënies në nivel bashkie

#### Fusha I “Për organizimin dhe funksionimin e bashkisë”

##### Nënfushat:

**1. Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet** (Treguesit: Të dhëna për ndarjen administrativo-territoriale të bashkisë; Të drejtat, përgjegjësitë dhe misioni i bashkisë; Funksionet);

**2. Organet e bashkisë** (Treguesit: Përbërja dhe struktura; Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak; Rregullorja e Këshillit Bashkiak; Kalendar i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak; Njoftimet për mbledhjen e Këshillit Bashkiak; Rendi i ditës së Këshillit Bashkiak; Projekt-vendimet në proces shqyrtimi në Këshillin Bashkiak; Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak; Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ; Kryetari i Bashkisë; Procedurat e zgjedhjes; Detyrat dhe kompetencat; Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe paga e kryetarit; Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ; Orari i pritjes së qytetarëve; Adresa postare/ elektronike);

**3. Administrata e bashkisë** (Treguesit: Struktura organizative dhe numri i punonjësve; Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të administratës; Struktura e pagave; Orari i punës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë; Detyrat e administratës së njësive administrative; Organizimi dhe funksionimi i njësive në varësi; Njoftimet mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit; Adresa postare dhe elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive në varësi të bashkisë; Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë);

**4. Procedurat e bërjes së kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve lidhur me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës** (Treguesit: Procedura për të bërë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë; Rregullorja e brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidentalitetit; Njësia përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet; Adresa postare/electronike për depozitim të kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve; Afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet.)

## Fusha II “Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare”

### Nënfushat:

- 1. Kalendar i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor** (Tregues: vetë Kalendar);
- 2. Paketa fiskale** (Tregues: baza e taksave dhe tarifave; niveli i taksave dhe tarifave; përjashtimet dhe lehtësimet e subjekteve të caktuara; afatet e pagesave; gjobat dhe kamatëvonesat);
- 3. Plani strategjik i zhvillimit të bashkisë** (Treguesit: politikat për zhvillimin e qëndrueshëm; marrja në konsideratë e nevojës dhe potencialeve të zhvillimit vendor; paraqitja e synimeve kryesore në çdo fushë; identifikimi i veprimeve që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse; burimet e financimit);
- 4. Program buxhetor afatmesëm vendor** (Treguesit: dokumenti i parë i PBA-së; Dokumenti i rishikuar i PBA-së; Dokumenti i plotë i PBA-së);
- 5. Buxheti vjetor** (Treguesit: buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin; treguesit financiarë; numri i punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese; regjistri i parashikimeve të prokurimit publik);
- 6. Zbatimi i buxhetit** (Tregues: Raporti mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve);
- 7. Monitorimi, mbikëqyrja dhe auditimi i buxhetit** (Treguesit: raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit; raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit; informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve); regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit);
- 8. Vështirësitë financiare** (Tregues: plani për daljen nga situata e vështirë financiare);
- 9. Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe asetëve** (Treguesit: publikimi i asetëve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira; kriteret që duhet të plotësohen, sipas legjislacionit);
- 10. Donacionet** (Treguesit: emri i donatorit; shuma e donacionit; qëllimi i donacionit).

## Fusha III “ Kërkesat për informim”

### Nënfushat:

**1. Të dhënat e koordinatorit për informim** (Treguesit: Emër mbiemër i koordinatorit; Adresa postare/ elektronike e tij; Orari i punës; Detyrat dhe kompetencat e koordinatorit; Adresa postare/electronike për depozitimin e kërkesave për informim);

**2. Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim** (Treguesit: Procedura që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion; Adresa postare/ elektronike për dërgimin e kërkesës për informim; Modeli standard i një kërkesë për informim; Afatet e marrjes së përgjigjes; Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim për mosdhënie informacioni; Adresa postare/electronike për dërgimin e ankimit për mosdhënie informacioni);

**3. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve** (Treguesit: Të gjitha kërkesat për informim; Informacioni i dhënë në përgjigje të tyre; Përditësimi çdo 3 muaj);

**4. Informacioni i dhënë më pare** (Tregues: Informacion i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen);

**5. Trajtimi i kërkesave për informacion** (Treguesit: Procedura e regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve; Afatet e trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë; Mënyra e dhënies së informacionit);

**6. Kufizimi i së drejtës për informim** (Tregues: Rastet e kufizimit të së drejtës për informim sipas ligjit për te drejtën për informim);

**7. Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka** (Treguesit: Të gjitha kërkesat për informim; Informacioni i dhënë në përgjigje të tyre; Përditësimi çdo tre muaj);

**8. Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh** (Tregues: Informacione dhe dokumente të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim).

## Fusha IV “Shërbimet që ofron bashkia

### Nënfushat:

#### **1. Shërbimet publike sipas 7 fushave të funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi**

(Treguesit: Instrumenti për administrimin e shërbimit; Sistemi i administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standard; Sistemi i treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës; Struktura përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor; Një organizim/grupim në disa fusha, me qëllim lehtësimin e aksesit);

#### **2. Shërbimet administrative sipas 7 fushave të funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi**

(Treguesit: Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit; Adresa postare/elektronike e strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative; Procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbimet administrative; Oraret e punës së strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative; Tarifat për shërbimet administrative; Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës; Subjektet që përjashtohen nga tarifat; Organizimi në fusha sipas funksioneve të përcaktuara në ligj);

**3. E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet** (Treguesit: Procedurat për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet; Adresën postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve)

## Fusha V “Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore”

### Nënfusha:

**1. Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore** (Treguesit: I organizuar sipas funksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi; Përmban aktet ligjore dhe nënligjore të fushës; Përmban dokumentet politike kombëtare përkatëse; Përmban vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit bashkiak me karakter normativ; Përmban vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ; Përmban dokumentet politike vendore

## Fusha VI “Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”

### Nënfushat:

- 1. Të dhënat e koordinatorit për njoftimin e konsultimin publik** (Treguesit: Emër mbiemër i koordinatorit; Adresa postare/elektronike e tij; Orari i punës);
- 2. Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje** (Treguesit: Aktet që do të konsultohen; Veprimet që do të ndërmerren; Afatet e realizimit të veprimeve; Strukturat përgjegjëse);
- 3. Dispozitat e brendshme rregullatore për këshillimin me publikun** (Treguesit: Procedurat, afatet dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi; Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim);
- 4. Akte për të cilat është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik; Akte për të cilat është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik** (Treguesit: Lista e akteve për të cilat është e detyrueshme të zhvillohet konsultimi publik);
- 5. Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje** (Treguesit: Projektakti, relacioni shpjegues dhe dokumentet shoqëruese; Arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë; Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; Adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik ose e strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve për projektaktin; Vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij);
- 6. Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve** (Treguesit: Adresa postare/elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve; Afati për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve; Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit në takimet publike; Mënyra e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve; Mënyra e dhënies së arsyeve për mospranimin e komenteve dhe rekomandimeve)
- 7. Procedurat e ankimimit lidhur me procesin e këshillimit me publikun** (Treguesit: Subjektet ku mund të ankohet: Kryetari i bashkisë; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale); Adresa postare/ elektronike për dërgimin e ankimit; Procedurat për të bërë një ankim në lidhje këshillimit me publikun; Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankimin)
- 8. Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes** (Treguesit: Numri i akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti; Numri i përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; Numri i takimeve publike të organizuara)
- 9. Nisma qytetare** (Treguesit: Mënyra dhe forma e paraqitjes së nismës qytetare; Procedura e shqyrtimit dhe e miratimit të nismës qytetare; Adresa postare/ elektronike për depozitimin e nismës qytetare; Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mosmiratimin e nismës qytetare)

## Fusha VII - Informacion tjetër:

### Nënfushat:

- 1. Bashkia në proceset e integritit evropian** (Tregues: Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtaritë e bashkisë në kuadrin e integritit në BE)
- 2. Bashkia dhe shoqëria civile** (Treguesit: Në tërësi të dhëna për grupet e interesit; Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit; Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme; Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile)
- 3. Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Transparencës** (Tregues: Informacioni i publikuar përmban të gjithë elementet e ofruar nga realizuesi)
- 4. Strukturat komunitare** (Treguesit: Të dhëna për strukturat komunitare në fshat; Të dhëna për strukturat komunitare në qytet; Detyrat dhe kompetencat e strukturave; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare)

